



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 622 Akti

Nr. 677 Vendimi

Tiranë, më 19.6.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda Bekteshi	Kryesuese
Lulzim Hamitaj	Relator
Etleda Çiftja	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Gledis Hajdini, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në datën 16.6.2023, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:

Znj. Engjellushe Tahiri me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm Krujë.

OBJEKTI:

Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Engjëllushe Tahiri, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e cila në seancën dëgjimore publike të datës 16.6.2023 kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Engjëllushe Tahiri, gjatë periudhës së fillimit të procesit të hetimit administrativ, ka ushtruar detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë. Për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
2. Subjekti i rivlerësimit Engjëllushe Tahiri u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt në shortin e hedhur në datën 15.12.2020 nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.
3. Trupi gjykues, me vendimin nr. 1, datë 21.12.2020, vendosi të fillojë një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesues të trupit gjykues komisioneren Brunilda Bekteshi, pasi të gjithë anëtarët deklaruan mospasjen e konfliktit të interesit. Nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
4. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga subjekti i rivlerësimit janë nisur procedurat e rivlerësimit, si vijojnë:
 - a) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës së pasurisë sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, pranë ILDKPKI-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
 - b) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës për kontrollin e figurës sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, pranë DSIK-së (aktualisht AKSIK), brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;
 - c) plotësimi dhe dërgimi i formularit të vetëvlerësimit profesional sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016 pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi, sipas nenit 41 të ligjit nr. 84/2016.
5. Gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit me anë të postës elektronike, me *email*-in e datës 18.1.2021, konfirmoi mospasjen e ndonjë konflikti interesi me të tre anëtarët e trupit gjykues.

6. Pas përfundimit të fazës hetimore mbi rivlerësimin e subjektit Engjëllushe Tahiri, me vendimin nr. 2, datë 5.6.2023, trupi gjykues vendosi të mbyllë hetimet dhe në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 vlerësoi që procesi i rivlerësimit për këtë subjekt të bazohej në të tria kriteret e rivlerësimit të parashikuara nga ligji nr. 84/2016.
7. Në datën 6.6.2023, Komisioni e njoftoi subjektin e rivlerësimit nëpërmjet postës elektronike mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe e ftoi atë për t'u njohur me dosjen dhe me provat e administruara prej tij, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, për të paraqitur shpjegimet dhe për të provuar të kundërtën e rezultateve të kristalizuara në fund të hetimit administrativ, duke i dhënë kohë deri më 13.6.2023.
8. Subjekti i rivlerësimit u paraqit për t'u njohur me dokumentacionin e dosjes së hetimit administrativ dhe ka tërhequr dokumentacionin përkatës në format elektronik, që iu vu në dispozicion edhe fizikisht, së bashku me rezultatet e hetimit kryesisht.
9. Me anë të postës elektronike të datës 13.6.2023, subjekti paraqiti prapësimet e veta brenda afatit të caktuar dhe depozitoi dokumentacionin në zyrën e protokollit të Komisionit, në të njëjtën datë.
10. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet vendimit nr. 3, datë 14.6.2023, vendosi të caktojë seancën dëgjimore në datën 16.5.2023, duke njoftuar subjektin përmes postës elektronike për këtë vendimarrje.

II. SEANCA DËGJIMORE

11. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 16.5.2023, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova.
12. Në vijim, pasi dëgjoi relacionin, subjekti i rivlerësimit Engjëllushe Tahiri parashitri shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke iu referuar edhe shpjegimeve të paraqitura më herët me shkrim. Në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë. Seanca dëgjimore e datës 16.6.2023 u mbyll për të rifilluar më 19.6.2023, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

13. Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë kur i është kërkuar – sipas parashikimeve të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 – përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI

14. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (i) provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (iii) raportin mbi kontrollin e figurës të dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja; (iv) provat shkresore/dokumentet e

administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (v) raportin e përpiluar nga KLP-ja; (vi) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (vii) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative; (viii) argumentet e paraqitura në seancën dëgjimore; (ix) faktet e njohura botërisht.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. VLERËSIMI I PASURISË NGA ILDKPKI-ja

15. Bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke konstatuar se:
- deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
 - ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
 - nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
 - nuk ka kryer deklarim të rremë;*
 - subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*
16. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.
17. Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë ka konsistuar në: verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuara nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

A/2. RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

1. Apartament banimi me sipërfaqe 90.8 m², në “**”, Tiranë**

1. Pasuria e llojit apartament banimi me sipërfaqe 90.8 m² (nr. pasurie “****”, z. k. “****”, vol. “****” dhe f. “****”) është deklaruar fillimisht nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2015, në emër të bashkëpronarëve Engjëllushe Tahiri, I.T., (babai i subjektit), M.T., (nëna e subjektit) dhe Z.T., (motra e subjektit) – të cilët zotërojnë secili 1/4 pjesë të kësaj pasurie.
2. Subjekti ka deklaruar se këtë pasuri në bashkëpronësi e kanë përfitur nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. “****”, datë 17.9.2015, nga shitësit Gj.M., dhe M.A., kundrejt çmimit 7.000.000 lekë.
3. Nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit administrativ nga ASHK-ja¹ dhe nga kontrolli i kryer nga Komisioni *online* në sistemin multifunksional të ASHK-së

¹ Shkresë nr. “****” prot., datë 3.1.2018.

për institucionet, është konfirmuar pasuria në analizë në emër të subjektit, prindërve dhe motrës së saj.

4. Nga Ministria e Drejtësisë² janë përcjellë të dhënat nga RNSH-ja³ ku, ndër të tjera, ka rezultuar edhe kontrata me nr. “****”, datë 17.9.2015, për shitblerjen e pasurisë në analizë në vlerën 7.000.000 lekë.
5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar ka rezultuar se shitësit e kishin blerë këtë pasuri në vlerën 49.345 euro (rreth 6.918.169 lekë) me anë të kontratës nr. “****”, datë 21.1.2015. Pasuria në fjalë i është shitur subjektit, prindërve dhe motrës së saj rreth 8 muaj më pas në vlerën 7.000.000 lekë.
6. Si burim financiar për krijimin e kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar se kanë shërbyer: (i) të ardhurat nga shitja e një pasurie në pronësi të nënës së saj në vlerën 5.000.000 lekë; (ii) një kredi e marrë nga subjekti në vlerën 520.000 lekë në “Raiffeisen Bank”; (iii) si dhe shuma prej 1.500.000 lekësh, nga kursimet familjare të deklaruara ndër vite.
7. Në referencë të udhëzimit nr. 4, datë 30.9.2015 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2015”, sipas të cilit ka rezultuar se çmimi mesatar i shitjes së banesave në tregun e lirë për vitin 2015, në zonën “****”, në të cilën gjendet edhe pasuria në fjalë, ka qenë në vlerën 65.000 lekë/m², Komisioni ka kryer një analizë krahasimore mes çmimit të dakordësuar nga palët në kontratën e shitblerjes dhe të dhënave të tregut të lirë, në vitin 2015, kur është blerë pasuria. Nga analiza e kryer ka rezultuar një çmim prej 5.902.000 lekësh për apartamentin me sipërfaqe 90.8 m².
8. Në përfundim të kësaj analize, trupi gjykues vëren se nuk konstatohet ndonjë trajtim preferencial i subjektit nga ana e shitësve, pasi nga të dhënat e analizuara ka rezultuar se pasuria në fjalë është blerë me një çmim më të lartë krahasuar me çmimet referencë të kohës.
9. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se ka filluar të banojë në apartamentin në fjalë, pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes në datën 17.9.2015. Për sa i përket mobilimit të këtij apartamenti, subjekti ka sqaruar se veç zonës së kuzhinës, e cila ka qenë e kompletuar në momentin e blerjes, për ambientet e tjera të tij janë përdorur fillimisht mobiliet që familja dispononte në banesën e mëparshme të ndodhur në qytetin e Kavajës. Pas likuidimit të kredisë që familja kishte marrë për blerjen e apartamentit, mobiliet e vjetra janë zëvendësuar me të reja gjatë periudhës maj 2017 – fundvit 2019, të cilat kanë kushtuar rreth 160.000 lekë.
10. Nga FSHU-ja⁴ nuk është konfirmuar kontratë në emër të subjektit apo personave të lidhur, ndërsa nga UKT-ja⁵ është konfirmuar një kontratë me nr. “****”, në emër të

² Shkresë nr. “****” prot., datë 26.3.2021.

³ Gjithashtu, në këtë regjistër kanë rezultuar edhe kontratat për pjesëtimin e pasurisë së paluajtshme ndërmjet nënës së subjektit dhe motrës së saj, si dhe kontrata për shitjen e pasurisë së paluajtshme nga nëna e subjektit të rivlerësimit, të cilat trajtohen në vijim në këtë vendim.

⁴ Me shkresën nr. “****” prot., datë 22.4.2021. Në këtë shkresë është bërë me dije se kanë rezultuar 4 abonentë me të dhënat I.T., në Vlorë, Fier, Kukës dhe Burrel dhe 2 abonentë me gjeneralitetet M.T., në instancën Elbasan. Nga FSHU-ja është sqaruar se referuar sistemit të të dhënave të këtij institucioni, disponohen vetëm emrat dhe mbiemrat e abonentëve dhe jo atësia e tyre. Për rrjedhojë është e pamundur të përcaktohet nëse bëhet fjalë për të njëjtët persona të cituar në shkresë.

⁵ Me shkresën nr. “****” prot., datë 30.3.2021, si dhe me shkresën nr. “****” prot., datë 31.3.2023.

znj. Z.T., (motrës së subjektit), për objektin me adresë rruga “****”.

11. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka paraqitur librezën për furnizimin me ujë të pijshëm, në emër të motrës Z.T., sipas së cilës kanë rezultuar pagesa të kryera për këtë shërbim, duke filluar nga muaji nëntor i vitit 2015.
12. E pyetur në lidhje me marrëdhënien me shitësit e apartamentit në analizë (shtetasit Gj.M., dhe M.A.), subjekti ka deklaruar se nuk ka pasur asnjë marrëdhënie shoqërore/familjare apo të çfarëdolloji dhe as konflikt interesi me këta shtetas – dhe se për shitjen e apartamentit në analizë ajo kishte marrë dijeni përmes njoftimeve në gazetë.

1.1 Analiza e burimeve të krijimit të pasurisë

13. Në deklaratën *Vetting*, sikurse është cituar edhe më sipër, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se për blerjen e apartamentit të ndodhur në “****”, Tiranë, në vitin 2015 janë përdorur të ardhurat: (i) 500.000 lekë nga kredia bankare; (ii) 1.500.000 lekë kursime të deklaruara ndër vite; (iii) 5.000.000 lekë nga të ardhurat e shitjes së një pasurie të paluajtshme të nënës.

1.1.1. Lidhur me të ardhurat nga shitja e pasurisë së paluajtshme të nënës

14. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni ka rezultuar se nëna e subjektit, znj. M.T., ka pasur në pronësi një pasuri të llojit truall me nr. “****”, me sipërfaqe 575 m², mbi të cilin ndodhej pasuria ndërtesë me nr. “****”, me sipërfaqe 94.2 m². Kjo pasuri në emër të nënës së subjektit të rivlerësimit rrjedh nga kontrata e pjesëtimit nr. “****”, datë 21.8.2013, të pasurive të përbashkëta të saj dhe motrës H.Q.,⁶ të fituara me anë të vendimit nr. “****”, datë 31.10.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë së prindërve të tyre.
15. Më pas, shtetasja M.T., me kontratën e shitblerjes nr. “****”, datë 17.2.2015, ka shitur pasurinë me nr. “****”, truall me sipërfaqe 575 m² dhe atë me nr. “****”, ndërtesë me sipërfaqe 94.2 m², blerësve H., dhe B.B.⁷, në vlerën 5.000.000 lekë.
16. Nga shqyrtimi i lëvizjeve të llogarisë bankare të nënës së subjektit në ish “Veneto Bank” ka rezultuar se shuma prej 5.000.000 lekësh i është transferuar asaj në datën 27.2.2015 nga noter F.T., me përshkrimin “Kalim në depozitë pa afat të palës shitëse sipas kontratës nr. “****”, datë 17.2.2015, të derdhura nga H.B”.
17. Në datën 15.9.2015, znj. M.T., ka transferuar shumën në fjalë nga llogaria e saj në ish “Veneto Bank”, në llogarinë e saj në “Raiffeisen Bank” dhe, më pas, në datën 17.9.2015 ka transferuar shumën 5.000.000 lekë në favor të noteres E.K., me përshkrimin “Kalim sipas kontratës së shitblerjes nr. “****”, datë 17.9.2015, likuidim i pjesshëm”. Në të njëjtën datë, 17.9.2015, nga llogaria e subjektit të rivlerësimit Engjëllushe Tahiri është transferuar në llogarinë e noteres E.K., shuma 2.000.000

⁶ Referuar vërtetimit hipotekor të datës 16.8.2013, znj. M., dhe znj. H., kanë qenë bashkëpronare të pasurisë nr. “****”, truallit me sipërfaqe 236 m², ndërtesës me sipërfaqe 107 m², pasurisë me nr. “****”, truallit me sipërfaqe 575 m² dhe ndërtesës me sipërfaqe 94.2 m². Shtetasja M.T., ka marrë në pronësi të saj pasurinë e përshkruar më sipër. Ndërsa, shtetasja H.Q., ka marrë në pronësi të saj pasurinë me nr. “****”, me sip. 236 m², nga e cila 107 m² ishte ndërtesë.

⁷ Gjithashtu, në përgjigjet e saj të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se nuk ka pasur dhe nuk ka asnjë marrëdhënie shoqërore/familjare apo të çfarëdolloji me shtetasit H., dhe B.B. Këta shtetas kanë kontaktuar prindërit e saj për blerjen e banesës dhe truallit dhe transaksioni është kryer prej tyre.

lekë, me përshkrimin “Kalim sipas kontratës së shitblerjes nr. “****”, datë 17.9.2015, kalim i pjesshëm”, duke u plotësuar kështu shuma totale prej 7.000.000 lekësh e çmimit të blerjes së pasurisë.

18. Subjekti ka deklaruar se me palën shitëse të pasurisë nuk ka pasur asnjë marrëdhënie dhe as konflikt interesi. Ky fakt është konfirmuar edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë⁸, e cila ka bërë me dije se nuk kanë rezultuar çështje gjyqësore të shqyrtuara nga subjekti i rivlerësimit Engjëllushe Tahiri, me palë shtetasit Gj. M., M. A., H. B., dhe B. B.
19. Në funksion të analizimit të burimit të ligjshëm të shumës prej 5.000.000 lekësh, të përfituar nga shitja e banesës në Kavajë dhe e përdorur për likuidimin e pjesshëm të çmimit të blerjes së apartamentit në fjalë, Komisioni ka kryer vlerësimin në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, dhe sipas këtij parashikimi: “[...] Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore [...], ndaj për qëllim të procesit të rivlerësimit të kriterit të pasurisë, si të ardhura të ligjshme duhen konsideruar vetëm të ardhurat të cilat plotësojnë në mënyrë kumulative këto dy kritere: (i) që janë deklaruar; dhe (ii) për të cilat vërtetohet pagimi i detyrimeve tatimore sipas legjislacionit në fuqi”. Rrjedhimisht, trupi gjykues, nisur nga fakti i plotësimit të kushteve të sipërcituara, si dhe faktit se historiku i krijimit dhe i transferimit të kësaj shume, ka rezultuar i gjurmueshëm përmes veprimeve dhe transaksioneve bankare (nga krijimi deri në transferimin final në llogarinë e noterit publik), në mbështetje të dispozitave të sipërcituara dhe të praktikës së konsoliduar të Kolegjit⁹, vlerëson se këto fakte janë të mjaftueshme për të konkluduar se vlera prej 5.000.000 lekësh ka qenë një e ardhur e ligjshme që është përdorur për krijimin e pasurisë në analizë.

1.1.2. Lidhur me kursimet ndër vite

20. Nga shqyrtimi i llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit ka rezultuar se shuma prej 2.000.000 lekësh është formuar nga: (i) maturimi në datën 23.2.2015 i depozitës bankare prej 1.000.000 lekësh; (ii) shuma 400.000 lekë, e transferuar nga llogaria e pagës në datën 7.8.2015; (iii) shuma 100.000 lekë, e transferuar nga llogaria e pagës në datën 8.9.2015; dhe (iv) shuma 500.000 lekë nga kredia bankare e disbursuar në datën 14.9.2015.
21. Depozita bankare është deklaruar prej subjektit fillimisht në DIPP-në e vitit 2010, e çelur për herë të parë në shumën 600.000 lekë, në datën 5.5.2010. Kjo shumë ka rezultuar të jetë akumuluar në llogarinë e pagës së subjektit, me të ardhurat nga pagat e saj të kredituara në këtë llogari, fillimisht nga bursa e përfituar nga Shkolla e Magjistraturës e, më pas, nga pagat përgjatë periudhës së stazhit profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
22. Më tej, kjo depozitë është shtuar përkatësisht me shumat: (i) 179.804 lekë, e akumuluar nga të ardhurat nga pagat deri në datën 15.6.2011; (ii) 221.400 lekë, e akumuluar nga të ardhurat nga pagat deri në datën 23.1.2012; si dhe (iii) të ardhurat

⁸ Me shkresën nr. “****” prot., datë 22.11.2022.

⁹ Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 6/2019 (JR), paragrafi 21.12; nr. 23/2020 (JR), paragrafi 25.4; nr. 35/2021 (JR), paragrafi 18.6.

nga interesat e përfituar deri në datën 23.1.2012, duke arritur vlerën totale prej 1.040.000 lekësh.

23. Ndërsa shumat prej 400.000 lekësh dhe 100.000 lekësh, të transferuara nga llogaria e pagës, përkatësisht në datat 7.8.2015 dhe 8.9.2015, janë konfirmuar të jenë krijuar nga akumulimi i pagave të kredituara në llogarinë e subjektit prej muajit mars 2015 deri në shtator 2015.
24. Nga sa më sipër, është konfirmuar edhe krijimi i kursimeve prej 1.500.000 lekësh, me burime të ligjshme financiare nga të ardhurat nga pagat e subjektit ndër vite.

1.1.3. Lidhur me kredinë bankare

25. Referuar kontratës së kredisë së datës 11.9.2015, subjektit të rivlerësimit i është akorduar një kredi nga “Raiffeisen Bank” në shumën 520.000 lekë, me afat shlyerjeje prej 18 muajsh, për arsye personale. Nga kredia e disbursuar janë mbajtur komisionet bankare përkatëse prej 20.000 lekësh dhe shuma e mbetur prej 500.000 lekësh është transferuar në llogarinë e kursimit, ku së bashku me shumat e mësipërme nga kursimet është formuar shuma prej 2.000.000 lekësh, transferuar në llogarinë e noterit publik për blerjen e pasurisë në analizë.
26. Në këto kushte, në vlerësimin përfundimtar të të gjitha shpjegimeve, provave dhe rrethanave të evidentuara, analizuara e argumentuara më sipër lidhur me apartamentin e banimit me sipërfaqe 90.8 m², të ndodhur në “****”, Tiranë, trupi gjykues konkludon se subjekti ka kryer deklaram të saktë në përputhje me nenin 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, si dhe ka pasur burime të ligjshme financiare për krijimin e kësaj pasurie.

2. Lidhur me pasurinë e llojit tokë arë me sipërfaqe 2.500 m², në “**”, Kavajë**

27. Subjekti ka deklaruar për herë të parë në deklaratën e interesave privatë përpara fillimit të detyrës në vitin 2009 pasurinë e llojit tokë arë me nr. “****”, vol. “****”, f. “****”, me sipërfaqe 2.500 m², z. k. “****”, në “****”, Kavajë, e përfituar me anë të AMTP-së nr. “****”, viti 1997, nga babai i saj I. T.
28. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se këtë pasuri e zotëron në masën ¼ pjesë të saj¹⁰. Bashkëngjitur deklaratës *Vetting*, subjekti ka paraqitur certifikatën për vërtetim pronësie nga ZVRPP-ja Kavajë të pasurisë arë, me sipërfaqe 2.500 m², e regjistruar në emër të shtetasit I.T., në cilësinë e kryefamiljarit të familjes bujqësore, si dhe AMTP-në nr. “****” akti, të datës 30.8.1997, me anë të së cilës, në mbështetje të ligjit nr. 7501 “Për tokën”, datë 19.7.1991, familjes së shtetasit I.S.T., i jepet në pronësi gjithsej 3.000 m² tokë, nga të cilat 2.500 m² tokë arë, si dhe 500 m² ullishtë. Ndonëse pasuria me sipërfaqe 500 m² ullishtë ka qenë pjesë e pasurisë tokë arë, sipas AMTP-së nr. akti “****”, në momentin e regjistrimit të kësaj të fundit, ajo nuk ka rezultuar e regjistruar në emër të babait të subjektit.
29. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se mbi pasurinë në analizë nuk është bërë asnjë investim dhe se prej vitesh kjo pronë nuk përdorej më nga familja e saj. Kjo pasuri ka mbetur e regjistruar formalisht në emër të babait të saj, i cili i ka

¹⁰ Në kohën e përfitimit të të drejtave reale mbi pasurinë në fjalë subjekti ka qenë në përbërje familjare me babain, nënën dhe motrën e saj. Referuar ligjit nr. 7501 “Për tokën”, anëtarët e familjes bujqësore kanë qenë bashkëpronarë në këtë pasuri.

shkëputur lidhjet me këtë pasuri prej shumë vitesh. Në vijim, në pyetësin nr. 3, pasi është pyetur nga Komisioni lidhur me mosdeklarimin në DIPP-të ndër vite dhe në deklaratën *Vetting*, të pasurisë së llojit ullishtë me sipërfaqe 500 m², subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se kjo pasuri nuk është regjistruar në emër të babait të saj dhe se nuk ka asnjë informacion për të.

30. Nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës¹¹ Kavajë (në vijim ASHK), si dhe nga verifikimi *online* i kryer nga Komisioni në sistemin multifunksional të ASHK-së për institucionet, është konstatuar se në datën 10.2.2004 është kryer regjistrimi i përkohshëm i pasurisë tokë arë me sipërfaqe 2.500 m², z. k. “****”, nr. pasurie “****”, në emër të z. I.T.
31. Nisur nga sa më sipër, si dhe bazuar në dokumentacionin e pasurisë në fjalë, trupi gjykues, mbështetur në parashikimin kushtetues të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, në kontekst të vlerësimit të të dyja aspekteve të kriterit të pasurisë, konkretisht verifikimit të saktësisë dhe plotësisë së deklaramit të kryer nga ana e subjektit lidhur me këtë pasuri, si dhe të kontrollit lidhur me mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për ta krijuar atë, ka marrë në konsideratë sa vijon:
- i) Të drejtat reale mbi pasurinë e paluajtshme në analizë janë përfituar nga babai i subjektit në vitin 1997, pra shumë vite përpara emërimit të saj në detyrën e gjyqtarës.
 - ii) Në kuadër të detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, vërtetësinë e deklaramit të sipërcituar në deklaratën e pasurisë *Vetting* e ka justifikuar me dokumentacionin që është paraqitur bashkë me deklaratën *Vetting* dhe konkretisht AMTP dhe certifikatë vërtetimit pronësie, sikurse janë përshkuar më sipër.
 - iii) Në momentin e deklaramit për herë të parë nga subjekti, pasuria tokë ka qenë e regjistruar në emër të babait të subjektit si pasuri tokë arë me sipërfaqe 2.500 m², sikurse është deklaruar edhe nga subjekti, pavarësisht ndryshimeve të pësuar përgjatë viteve dhe faktit se në dokumentin fillestar ishte cituar edhe pasuria ullishtë me sipërfaqe 500 m². Kësisoj, çmohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka munguar të deklarojë në deklaratën *Vetting* ndonjë pasuri, e cila të ketë qenë në pronësi të saj në momentin e deklaramit. Përkundrazi, edhe për pasuritë e regjistruara në emër të të atit, në cilësinë e përfaqësuesit të familjes, subjekti ka deklaruar pjesën takuese në bashkëpronësi në cilësinë e anëtares së familjes.
 - iv) Përgjatë hetimit administrativ nuk ka rezultuar që mbi këtë pasuri tokë të ishin kryer investime në ndonjë vlerë monetare, nga ku mund të vlerësohej aspekti deklarues, si dhe verifikimi mbi mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme.
32. Nisur nga sa më sipër, trupi gjykues ka konkluduar se nuk janë konstatuar problematika në lidhje me deklaramin apo me ligjshmërinë e krijimit të pasurisë në fjalë.

3. Automjet tip “Ford Focus”, me vlerë 144.000 lekë

¹¹ Shkresë nr. “****” prot., datë 3.10.2016.

33. Subjekti ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2014 dhe më pas në deklaratën *Vetting* pasurinë e llojit automjet tip “Ford Focus”, me targë “****”, të përfituar me anë kontratës së shitblerjes¹² datë 13.5.2014, nënshkruar mes subjektit dhe shoqërisë “****” sh.p.k., kundrejt çmimit 144.000 lekë. Si burim krijimi për shumën 144.000 lekë subjekti ka deklaruar se janë përdorur të ardhurat nga paga.
34. Bashkëngjitur deklaratës *Vetting*, subjekti ka paraqitur kontratën e shitblerjes së automjetit dhe faturën tatimore të shitjes nr. “****”, datë 13.5.2014, si dhe deklaratën për zhdoganimin e tij në datën 24.4.2014, nga shoqëria shitëse kundrejt tarifës doganore prej 21.179 lekësh.
35. Nga DPSHTRR-ja¹³ është bërë me dije se nuk kanë rezultuar automjete të tjera (veç atij të deklaruar nga subjekti) në pronësi të subjektit dhe personave të lidhur. Gjithashtu, ky institucion ka përcjellë dosjen e automjetit në analizë, nga shqyrtimi i së cilës ka rezultuar se pala shitëse e kishte blerë këtë pasuri më herët në shtetin italian kundrejt çmimit 600 euro.
36. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se për kryerjen e pagesës në vlerën 144.000 lekë kanë shërbyer të ardhurat e saj nga paga në llogarinë bankare pranë “Raiffeisen Bank”. Nga shqyrtimi i lëvizjeve në llogarinë bankare të pagës së subjektit ka rezultuar tërheqja e shumës prej 150.000 lekësh gjatë periudhës 7.5.2014 – 9.5.2014, e cila duket e mjaftueshme për kryerjen e pagesës në fjalë. Gjithashtu, ka rezultuar se kjo shumë ka qenë e akumuluar në këtë llogari, me burim të ardhurat nga paga të subjektit.
37. Për më tepër, Komisioni ka kryer edhe analizën financiare përgjatë periudhës 1.1.2014 – 13.5.2014 (data e pagesës së çmimit të blerjes), nga e cila ka rezultuar gjithashtu një mjaftueshmëri e burimeve të ligjshme financiare, sipas detajimit në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 1 – Analiza financiare për blerjen e automjetit

Te ardhura nga paga e subjektit 1.1.2014 - 13.5.2014	516,500
Te ardhura nga pensionet e prinderve janar - maj 2014	135,462
Shpenzime jetese janar - maj 2014 (per 4 persona)	(366,663)
Shpenzime udhetime 1.1.2014 - 13.5.2014	(4,203)
Shpenzime transporti	(37,800)
Shpenzim per blerjen e automjetit	(144,000)
Rezultati ne 13.5.2014	99,295

38. E pyetur në lidhje me shitësin e këtij automjeti, subjekti ka deklaruar se nuk ka pasur asnjë marrëdhënie shoqërore/familjare apo të çfarëdolloji, përfshirë konfliktin e mundshëm të interesave përgjatë periudhës së ushtrimit të detyrës. Ky fakt është konfirmuar edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë¹⁴ dhe ajo Tiranë, të cilat kanë bërë me dije se nuk kanë rezultuar çështje të gjykuara nga znj. Engjëllushe Tahiri, me palë shoqërinë “****” sh.p.k., administratorin dhe ortakun e vetëm I.D., si dhe përfaqësuesin me prokurë të palës shitëse, z. A.D.

¹² Kontrata është e panoterizuar dhe mban vulën e DPSHTRR-së.

¹³ Me shkresën nr. “****” prot., datë 6.4.2021.

¹⁴ Me shkresën nr. “****” prot., datë 4.4.2023.

39. Nga të dhënat e sistemit TIMS, të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit¹⁵, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar jashtë vendit me automjetin e saj, si dhe me autobus dhe furgon. Nga verifikimet e kryera *online* në sistemin informatik të AMF-së nuk ka rezultuar që subjekti i rivlerësimit të ketë pasur në përdorim automjete të ndryshme nga ai i deklaruar në pronësi të saj.
40. Lidhur me shtetasit që kanë udhëtuar me subjektin, nga SPAK-u¹⁶ është konfirmuar se nuk kanë rezultuar procedime penale në ngarkim të tyre.
41. Në përfundim të sa është parashtruar më sipër, trupi gjykues ka arritur në përfundimin se nuk janë konstatuar problematika lidhur me deklarin e pasurisë automjet apo me burimin e ligjshëm të krijimit të saj.

4. Lidhur me vendbanimin e subjektit të rivlerësimit ndër vite

42. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se që nga momenti i marrjes së detyrës në vitin 2009, ajo ka banuar në qytetin e Kavajës me adresë Lagjja nr. “****”, “****”, pranë ish-Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, si dhe në adresën aktuale, rruga “****”, “****”, Tiranë.
43. Nisur nga fakti se në muajin shkurt të vitit 2015 pasuria e parë është shitur prej nënës së subjektit dhe apartamenti i ri është blerë në shtator 2015, Komisioni i ka kërkuar subjektin të bënte me dije mbi vendbanimin e saj dhe të anëtarëve të familjes përgjatë këtyre 7 muajve (shkurt - tetor) të vitit 2015.
44. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se gjatë periudhës së sipërcituar ka qëndruar në banesën e tezes së saj, me adresë Lagjja nr. “****”, Kavajë. Në mbështetje të deklarin të saj, lidhur me këtë rrethanë, subjekti ka paraqitur një deklaratë noteriale me nr. “****”, datë 7.4.2023, të lëshuar nga djali i tezes së saj, z. B.Q., në të cilën ai ka deklaruar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë përdorur banesën e nënës së tij të ndodhur në Lagjen nr. “****”, Kavajë.
45. Përpos vendbanimeve të sipërpërkruara, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit përgjatë periudhës 2011 – 2015, ndonëse banonte në Kavajë dhe punonte në Krujë, ka kryer në mënyrë të përsëritur tërheqje shumash monetare nga sportele bankomatesh, të pozicionuara në qytetin e Tiranës.
46. Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektin të rivlerësimit lidhur me shkakun e prezencës së vazhdueshme dhe të kryerjes së këtyre tërheqjeve monetare në qytetin e Tiranës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

47. Subjekti ka parashtruar se ka kryer studimet në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës në vitet 2001 – 2005 dhe gjatë kësaj kohe ka jetuar në qytetin e Tiranës. Për këtë arsye, edhe në vitet në vijim ajo ka udhëtuar shpesh nga Kavaja për në Tiranë dhe anasjelltas për arsye të ndryshme, qoftë edhe për shkak të afërsisë ndërmjet këtyre qyteteve. Edhe pas emërimit në funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë ka vijuar të mbajë kontakte të vazhdueshme me Shkollën e

¹⁵ Me shkresën nr. “****” prot., datë 26.3.2021.

¹⁶ Me shkresën nr. “****” prot., datë 8.11.2022.

Magjistraturës për të ndjekur trajnimet vazhduese të organizuara nga Shkolla apo nga organizma të tjerë kombëtarë e ndërkombëtarë.

48. Subjekti ka deklaruar gjithashtu se prej shumë vitesh, që nga koha e përfundimit të studimeve në Shkollën e Magjistraturës ka qenë e ftuar si pjesë e panelit të ekspertëve, në rolin e lehtësueses, në trajnimet që ky institucion ka zhvilluar për gjyqtarët dhe prokurorët. Ajo ka qenë e angazhuar në disa Universitete Private në qytetin e Tiranës, në procesin e mësimdhënies, - dhe aktualisht është pedagoge e jashtme në lëndën e të drejtës civile në Shkollën e Magjistraturës. Ndërsa karta e saj e bankës është përdorur herë pas here edhe nga motra e saj, e cila ka qenë me studime në Tiranë.

Vlerësimi i trupit gjykues

49. Trupi gjykues, në analizë të materialit të administruar, i ka vlerësuar shteruese dhe bindëse shpjegimet e subjektit dhe në referencë të jurisprudencës të konsoliduar të KPA-së¹⁷, ka konkluduar se nuk janë konstatuar problematika lidhur me vendbanimet e subjektit.

Ky konkluzion bazohet në faktin se trupi gjykues çmon se mosdeklarimi eksplicit në DIPP-në e vitit 2015, i përdorimit e një pasurie të paluajtshme në pronësi të personave të tretë, ndonëse përbën një pasaktësi në këtë deklaratë periodike vjetore, nuk mund të konkludohet se është bërë në kundërshtim me përcaktimin e shkronjës “a”, pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 – për më tepër, kur kjo banesë është përdorur vetëm për një periudhë të shkurtër kohore nga subjekti në marrëdhënie të veçantë. Ky vlerësim i Komisionit mbështetet edhe në fatet e konstatuara përgjatë hetimit administrativ, nga ku ka rezultuar se kjo pasuri ka qenë fillimisht në bashkëpronësi të nënës dhe tezes së subjektit (pronares aktuale), si një pasuri e përfitur nga trashëgimia. Më pas është bërë pjesëtimi i saj duke kaluar në pronësi të tezes së subjektit. Kësisoj, Komisioni çmon se rrethanat e lartpërskruara nuk lënë vend për dyshime të mundshme lidhur me origjinën dhe burimin e krijimit të pasurisë së përdorur nga subjekti¹⁸.

REZULTATET E ANALIZËS FINANCIARE

50. Komisioni ka kryer analizën financiare mbi deklaratimet periodike ndër vite të subjektit, pas përlllogaritjeve të kryera në mënyrë të detajuar sipas viteve, ku janë paraqitur të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përlllogaritja krahasimore e tyre lidhur me mjaftueshmërinë e burimeve financiare, për çdo vit, për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara, me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
51. Në këtë analizë janë konsideruar dhe përpunuar të dhënat duke filluar nga viti 2009, moment në të cilin fillon edhe deklarimi i pasurisë nga ana e subjektit të rivlerësimit, pranë ILDKPKI-së, deri në vitin 2016, nga ku ka rezultuar një bilanc i përgjithshëm

¹⁷ Në vendimet nr. 9/2020 (JR), datë 26.6.2020 dhe nr. 16/2020 (JR), datë 13.7.2020.

¹⁸ Referuar të dhënave të pasurisë sipas akteve të administruara përgjatë hetimit administrativ, krahasuar me të dhënat e pasurisë të cituara në deklaratën noteriale të z. B.Q., është konstatuar se bëhet fjalë për të njëjtën pasuri.

negativ në masën -247.228 lekë, siç është detajuar dhe përmbledhur në tabelën e mëposhtme, për të cilën Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës.

Analiza financiare për periudhën 2009 – 2016

	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
PASURI	210,932	305,386	161,831	351,178	8,167	-238,483	6,003,299	338,079
Are me sipërfaqe 2.500 m2 (7501)								
Automjet Ford Focus						144,000		
Apartament banimi ne b/pronesi							7,000,000	
Ndryshim likuiditeti	210,932	305,386	161,831	351,178	8,167	-382,483	-996,701	338,079
TOTAL LIKUIDITETE DEKLARUAR	464,751	770,137	931,968	1,283,146	1,291,313	908,830	-87,871	250,208
DETYRIME	0	0	0	0	0	0	520,000	0
Kredi ne Raiffeisen Bank							520,000	
PASURI NETO	210,932	305,386	161,831	351,178	8,167	-238,483	5,483,299	338,079
Të ARDHURA dokumentuar	866,970	937,761	1,108,336	1,240,430	1,284,981	1,624,696	6,569,450	1,548,600
Te ardhura nga paga e subjektit	738,406	802,691	837,121	836,675	841,116	1,298,043	1,168,764	1,214,188
Te ardhura nga mesimdhënia				85,140	65,538		29,490	7,373
Te ardhura nga interesat bankare		7,643	20,195	18,661	69,940	1,545	36,641	
Te ardhura nga shitja e pasurise se nenes							5,000,000	
Te ardhura nga paga e motres								
Te ardhura nga pensioni nenes	128,564	127,427	131,789	136,126	139,952	152,381	159,062	149,513
Te ardhura nga pensioni babait			119,231	163,828	168,435	172,727	175,493	177,526
SHPENZIME	546,480	596,880	647,280	679,567	674,711	954,263	1,067,842	1,457,749
Shpenzime jetese	546,480	546,480	546,480	564,096	564,096	879,992	897,104	940,368
Shpenzime udhetimi				14,671	9,815	19,571	43,430	135,059
Shpenzime kredie							111,478	366,463
Shpenzime siguracion automjeti						16,900	15,830	15,860
Shpenzime per transport ne vendin e detyres		50,400	100,800	100,800	100,800	37,800		
Analiza dokumentuar	109,558	35,495	299,225	209,685	602,104	908,916	18,309	-247,228
Gjendje cash në banesë								
Gjendje në llogaritë bankare	464,751	770,137	931,968	1,283,146	1,291,313	908,830	-87,871	250,208
DIFERENCA E PA MBULUAR			-247,228					

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

52. Në prapësime, subjekti ka kundërshtuar balancën negative në masën -247.228 lekë, të konstatuar nga Komisioni, duke pretenduar se shpenzimet e jetesës për prindërit e saj janë llogaritur më shumë se të ardhurat e përfituara prej tyre nga pensioni. Subjekti ka parashtruar se pensioni i babait është në vlerën 177.526 lekë dhe i nënës 149.513, të ardhura të cilat janë ndjeshëm më të ulëta sesa shpenzimet jetike të përllogaritura nga analiza financiare e kryer nga Komisioni.
53. Subjekti ka pretenduar që shpenzimet e jetesës së prindërve të llogariten referuar të ardhurave që ata kanë pasur, konkretisht për nënën që prej vitit 2002, ndërsa për babain që prej vitit 2011.

Vlerësimi i trupit gjykues

54. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi pretendimin e subjektit për reduktimin e shpenzimeve të jetesës për prindërit e saj pensionistë, vlerëson se shpenzimet e jetesës të konsideruara në analizën financiare, duke iu referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit¹⁹, konsiderohen si dyshemeja nën të cilën nuk mund të argumentohet, përveçse mbi

¹⁹ Vendimi nr. 8, datë 9.3.2021, sipas të cilit në paragrafin nr. 30 citohet se: “Shpenzimet bazike që përllogariten sipas INSTAT-it janë mbështetur mbi një mesatare të përgjithshme që përfshin edhe nivelin e varfërisë, bazuar në shpenzimet e përditshme jetike të qëndrimit dhe jetesës në Republikën e Shqipërisë dhe pagat mujore të këtushme. Ato referohen në mungesë të dokumentacionit si dyshemeja nën të cilën nuk mund të argumentohet, përveçse mbi prova shkresore”.

prova shkresore. Për rrjedhojë, në mungesë të provës së kundërt, ky pretendim i subjektit nuk mund të merret në konsideratë nga Komisioni.

Konkluzion përfundimtar lidhur me kriterin e pasurisë

55. Trupi gjykues, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, çmon se balanca negative që ka rezultuar për subjektin e rivlerësimit në vlerën 247.228 lekë, nuk përbën shkak për marrjen e masës disiplinore ndaj tij. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm të kontrollit të pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

56. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016 është përcjellë pranë Komisionit raporti nr. “****” prot., datë 30.10.2017, për subjektin e rivlerësimit, me të cilin ishte konstatuar përshtatshmëria e subjektit të rivlerësimit, znj. Engjëllushe Tahiri.
57. Më pas, në përgjigje të kërkesës së Komisionit²⁰, nga organet ligjzbatuese është bërë me dije se për këtë subjekt rivlerësimi nuk disponoheshin të dhëna të përditësuara për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme. Më pas, në datën 5.6.2023, raporti i AKSIK-së është deklasifikuar plotësisht nga organi kompetent me vendimin nr. “****” të KDZH-së.
58. Nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk ka rezultuar që subjekti i rivlerësimit të ketë qenë i përfshirë në veprimtari të kundërligjshme apo të ketë pasur ndonjë kontakt të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
59. Kësisoj, në përfundim të hetimit për kriterin e kontrollit të figurës, bazuar në informacionet dhe dokumentet e administruara, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit Engjëllushe Tahiri arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas parashikimit të nenit 59/1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë nga verifikimet e kryera: (i) nuk rezultoi që ajo të ketë pasur apo të ketë aktualisht kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; (ii) ka dorëzuar në kohë deklaratën për kontrollin e figurës; si dhe (iii) nuk ka bërë deklarime të pasakta, të paplota dhe nuk ka fshehur të dhëna apo kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

60. Komisioni, në bazë të neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka administruar dhe analizuar raportin e KLD-së, si dhe dokumentacionin e bashkëlidhur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Engjëllushe Tahiri, në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës.
61. Rivlerësimi i aftësive profesionale është mbështetur në: (a) raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer dhe të përcjellë në Komision; (b) informacionin e marrë nga burime të ligjshme, si i tillë është konsideruar

²⁰ Me shkresën e datës 21.6.2022.

informacioni i marrë nga denoncimet dhe organet ligjzbatuese – burime të cilat, kur ka qenë nevoja, i janë nënshtruar verifikimit të vërtetësisë së tyre nga Komisioni; (c) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

C/1. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE NGA KLGJ-ja

62. Raporti nr. “****” prot., datë 7.10.2021, i përcjellë nga KLGJ-ja, është hartuar duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit: (i) aftësive profesionale; (ii) aftësive organizative; (iii) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; (iv) aftësive personale dhe angazhimit profesional të subjektit të rivlerësimit. Ky raport është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (a) formularit të vetëdeklarimit, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit; (b) pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (c) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.
63. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit: (i) ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit, si dhe njeh parimet e përgjithshme të së drejtës së procesit të rregullt ligjor dhe i zbaton ato në praktikë; (ii) identifikon normën materiale të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret.
64. Me Dekretin nr. “****”, datë 7.1.2009, të Presidentit të Republikës, znj. Engjëllushe Tahiri është caktuar për të kryer stazhin profesional si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me Dekretin nr. “****”, datë 25.6.2010, të Presidentit të Republikës, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë. Me vendimin nr. “****”, datë 14.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ajo është komanduar në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë për një periudhë 3-vjeçare, ku dhe aktualisht vazhdon të ushtrrojë detyrën.
65. Sipas të dhënave nga databaza e ankesave, rezulton se gjatë periudhës 3-vjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Engjëllushe Tahiri janë paraqitur 6 ankesa (4 të vitit 2014, 1 e vitit 2015 dhe 1 e vitit 2016) në Inspektoratin e ish-KLD-së. Nga këto ankesa, 5 prej tyre janë arkivuar pas shqyrtimit paraprak, me arsyetimin se 2 prej tyre (1 e vitit 2014, dhe 1 e vitit 2016) janë ankesa të përsëritura, 2 prej tyre (1 e vitit 2014 dhe 1 e vitit 2015) janë arkivuar duke u bërë me dije ankuesve se duhet t’u drejtoheshin gjykatave më të larta dhe 1 ankesë e vitit 2014 është arkivuar, për shkak se është paraqitur në tejkalim të afatit 5-vjeçar të ankimit. Ndërsa, 1 ankesë e vitit 2014, e cila është verifikuar për mosrespektim formal të ligjit, është arkivuar, pasi nuk rezultuan shkelje procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit.
66. Nga databaza e regjistrit të procedimeve disiplinore, gjatë periudhës së rivlerësimit të subjektit Engjëllushe Tahiri, ka rezultuar një kërkesë për procedim disiplinor me nr. “****” prot., datë 6.12.2013, nga ministri i Drejtësisë, pranë ish-KLD-së²¹, për “Shkarkim nga detyra”, për moszbatim të vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara. Kërkesa është trajtuar në mbledhjen e ish-Këshillit në datën 15.4.2014, por është rrëzuar, duke u propozuar kështu masa vijuese “Vërejtje me paralajmërim”, masë e cila është miratuar nga ish-Këshilli në datën 15.4.2014.

²¹ Protokolluar pranë ish-Këshillit nr. “****” prot., datë 6.12.2013.

67. Subjekti i rivlerësimit Engjëllushe Tahiri e ka ankimuar vendimin e KLD-së në Gjykatën e Apelit Administrativ. Kjo e fundit, me vendimin nr. “****”, datë 7.7.2014, ka vendosur “Rrëzimin e kërkesëpadisë”.
68. Në vijim, subjekti i është drejtuar me rekurs Gjykatës së Lartë, e cila me vendimin nr. “****”, datë 5.5.2015, ka vendosur “Ndryshimin e vendimit nr. “****”, datë 7.7.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit dhe pranimin e padisë. Shfuqizimin e vendimit nr. “****”, datë 15.4.2014, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.

C/2. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE NGA KOMISIONI

69. Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLGJ-së, si dhe dokumentacionin e bashkëlidhur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës, duke shqyrtuar edhe informacionet e marra nga denoncimet nga publiku, si dhe aktet/vendimet/dosjet profesionale të administruara për këtë qëllim.
70. Pasi u njoh dhe analizoi dokumentacionin e depozituar nga KLGJ-ja, mbi të cilin është hartuar raporti i vlerësimit profesional për këtë subjekt rivlerësimi, Komisioni, përgjithësisht, sa i përket tri dokumenteve të vëna në dispozicion nga subjekti, por edhe atyre të administruara mbi bazë shorti, nuk vërejtí problematika të natyrës procedurale.
71. Gjatë hetimit administrativ, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë²² është bërë me dije se për subjektin e rivlerësimit Engjëllushe Tahiri është regjistruar kallëzimi penal nr. “****”, në vitin 2017. Nga shqyrtimi i dosjes së çështjes në fjalë, përcjellë nga Gjykata, ka rezultuar se shtetasi P. LL.²³ ka bërë kallëzim penal ndaj disa prokurorëve dhe gjyqtarëve, ndërmjet tyre edhe ndaj subjektit të rivlerësimit, duke pretenduar se ata kishin shpërdoruar detyrën.
72. Për këtë kallëzim, me vendimin e datës 27.2.2017, Prokuroria ka vendosur mosfillimin e procedimit penal me nr. “****”. Në vendimin në fjalë, Prokuroria ka parashtruar, ndër të tjera, se vendimet e gjykatave mbi të cilat ngrihen pretendimet e kallëzuesit janë në proces shqyrtimi nga gjykatat më të larta pas ankimit të tij. Pretendimi se këto vendime janë dhënë duke shpërdoruar detyrën, nuk përbën shkak për fillimin e procedimit penal. Ndërsa, në lidhje me pretendimin e kallëzuesit për dhënie të vendimit të padrejtë, Prokuroria është shprehur se neni 315, që rregullonte këtë rrethanë, është shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese. Prokuroria ka konkluduar se mungonin elementet e figurës së veprës penale “shpërdorim detyrë”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.
73. Pas ankimit të vendimit në fjalë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka arsyetuar se nuk ishte nevoja e kryerjes së verifikimeve apo hetimeve të tjera, tej atyre të kryera nga Prokuroria, për shkak se mungonin elementet e nevojshme për ekzistencën e veprës penale. Ajo e ka cilësuar të drejtë dhe të bazuar në procedurat ligjore vendimin e Prokurorisë. Në përfundim, me vendimin nr. “****”, datë 2.5.2017, ka vendosur

²² Me shkresën nr. “****” prot., datë 30.3.2021.

²³ Ky shtetas ka paraqitur edhe dy denoncime ndaj subjektit të rivlerësimit, të cilat analizohen në rubrikën “Denoncime nga publiku”.

rrëzimin e kërkesës penale të shtetasit P. LL. dhe lënien në fuqi të vendimit të mosfillimit të procedimit penal.

DENONCIME NGA PUBLIKU

74. Në Komision janë paraqitur 14 denoncime nga publiku, të cilat janë shqyrtuar së bashku me materialet përkatëse. Në vijim të analizimit të materialeve përkatëse lidhur me disa denoncime, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, janë administruar disa akte/dosje hetimore dhe gjyqësore për vlerësime më të thella lidhur me aspektin profesional të subjektit të rivlerësimit. Komisioni, pasi ka shqyrtuar denoncimet që janë paraqitur nga publiku pranë këtij institucioni, ka konstatuar se nga përmbajtja e një pjese të tyre nuk janë evidentuar prova mbi shkelje të mundshme të subjektit apo indicie mbi të cilat të mund të kryhej ndonjë hap hetimor i mëtejshëm, ndërsa mbi disa të tjerë janë kryer hetime të thelluara dhe janë administruar dokumente dhe informacione shtesë, siç janë trajtuar në vijim:

1. Denoncim nr. “**” prot., datë 8.1.2018, i shtetasit I.M.**

75. Denoncuesi ka pretenduar se nuk është informuar lidhur me procesin gjyqësor të finalizuar me vendimin nr. “****” akti, datë 3.6.2014, të dhënë nga subjekti i rivlerësimit Engjëllushe Tahiri.

76. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar²⁴ lidhur me procesin gjyqësor në analizë, ka rezultuar se denoncuesi ka paraqitur një kërkesë si ndërhyrës kryesor. Subjekti i rivlerësimit, pasi ka pyetur edhe palët në proces, të cilat kanë qenë kundër pranimin të kërkesës, si dhe nën arsyetimin se shqyrtimi gjyqësor kishte përfunduar dy seanca më përpara se të paraqitej kërkesa si ndërhyrës kryesor, ka vlerësuar se kjo kërkesë nuk plotësonte kriteret e përcaktuara në nenin 189 të Kodit Penal dhe si e tillë duhet të rrëzohej.

77. Për sa i përket pretendimit të denoncuesit se nuk ishte njoftuar lidhur me ecurinë e procesit gjyqësor, nga aktet e administruara²⁵ ka rezultuar se subjekti i ka komunikuar vendimin denoncuesit, duke e sqaruar se kjo vendimmarrje në këtë rast nuk cenonte të drejtën e pronësisë së pretenduar prej tij – pasi ai mund t’i drejtohej Gjykatës me një kërkesëpadi të re, por vendimmarrja lidhej me momentin procedural kur ai kishte paraqitur kërkesën.

78. Gjatë hetimit, Gjykata e Apelit Tiranë, me shkresën nr. “****” prot., datë 2.3.2023, ka bërë me dije se pranë kësaj Gjykate nuk është paraqitur ankim ndaj vendimit të sipërcituar.

79. Për sa më sipër, nuk janë konstatuar shkelje procedurale apo mangësi në arsyetimin e vendimit nga subjekti i rivlerësimit.

2. Denoncim nr. “**” prot., datë 20.9.2018, i shtetasit E.M.**

80. Denoncuesi ka pretenduar se nuk është pranuar kërkesa e tij për llojin e sigurisë së burgut ku do të kryente dënimin. Ai nuk ka paraqitur asnjë dokument/provë dhe as

²⁴ Shihni vendimin dhe arsyetimin përkatës, si dhe provat objekt gjykimi në këtë proces.

²⁵ Shihni njoftimet përkatëse, procesverbalet e seancave, fletëthirrjet e dërguara nga gjykata, nga ku ka rezultuar se shtetasi I. M. është njoftuar rregullisht për ecurinë e seancave gjyqësore. Nga analiza e vendimit ka rezultuar se subjekti ka sqaruar hapat proceduralë që duheshin ndjekur, sa i takon pretendimeve të denoncuesit.

nuk ka referuar ndonjë fakt apo rrethanë që dëshmon shkelje procedurale nga subjekti i rivlerësimit.

81. Nga shqyrtimi i vendimit²⁶ nr. “***” akti, datë 25.1.2018, të dhënë nga subjekti i rivlerësimit lidhur me kërkesën e paraqitur nga denoncuesi, ka rezultuar se subjekti e ka rrëzuar kërkesën, duke argumentuar ndër të tjera se i dënuari nuk kishte shfaqur sjellje korrekte në institucionin e vuajtjes së dënimit, për rrjedhojë kërkesa nuk plotësonte kriteret e përcaktuara në ligj.
82. Bazuar në ligjin 8331, datë 21.4.1998, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar, caktimi i llojit të sigurisë që duhet të ketë vendi i kryerjes së dënimit, sipas përcaktimit të bërë nga Gjykata në dispozitivin e vendimit penal kryesisht ose bazuar në kërkesën e prokurorit për përcaktimin e llojit të sigurisë, është në tagrin e organeve kompetente, bazuar në provat dhe rrethanat e çështjes konkrete.
83. Për sa më sipër, ndonëse denoncuesi nuk ka pretenduar ndonjë shkelje procedurale, nga analiza e vendimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit Engjëllushe Tahiri, ka rezultuar se vendimi është argumentuar dhe arsyetuar duke u bazuar në dispozitat ligjore përkatëse, që rregullonin çështjen objekt gjykimi dhe nuk është konstatuar cenim i të drejtave të palës apo shkelje procedurale që do të ngarkonin subjektin me përgjegjësi disiplinore.

3. Denoncim nr. “*” prot., datë 1.7.2019, nga shoqëria “*****” sh.p.k.**

84. Denoncuesi ka ngritur pretendime lidhur me procesin gjyqësor të finalizuar me vendimin nr. “***”, datë 13.12.2018, të dhënë nga subjekti i rivlerësimit Engjëllushe Tahiri. Në këtë proces, denoncuesi, në cilësinë e paditësit, kishte kërkuar *përbushjen e detyrimit kontraktor të palikuiduar për kryerjen e shërbimeve në vlerën 4.941.150 lekë, sipas faturës së TVSH-së, nga i padituri, shoqëria “*****” sh.p.k.* Ai ka pretenduar se nga ky vendim i ka ardhur një dëm ekonomik.
85. Në funksion të zgjidhjes së çështjes, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar ekspertimin grafik të faturës, kryerjen e ekspertimit kontabël për përlllogaritjen e detyrimit, përbushjen e detyrimit ligjor për lëshimin e saj, si dhe ka marrë në pyetje dëshmitarët sipas kërkesës së palëve ndërgjyqëse. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, subjekti i rivlerësimit ka arritur në konkluzionin se referuar aktit të ekspertimit, fatura e TVSH-së ka rezultuar e falsifikuar për sa i përket shkrimit dhe nënshkrimit. Gjithashtu, është konkluduar se nuk janë respektuar detyrimet ligjore për lëshimin e faturave për situacionet. Në këto kushte, ajo ka vlerësuar se padia është e pabazuar në ligj e në prova e, për rrjedhojë, e ka rrëzuar atë.
86. Ndonëse në një vlerësim të përgjithshëm pretendimet e denoncuesit lidheshin me themelin e çështjes, përgjatë hetimit Komisioni i është drejtuar edhe Gjykatës së Apelit Tiranë²⁷ lidhur me qëndrimin e mbajtur prej saj sa i përket vendimmarrjes së subjektit. Kjo Gjykatë ka bërë me dije se çështja në fjalë është në proces përpunimi dhe nuk ka ende një vendimmarrje për rastin në fjalë.

²⁶ Nga verifikimi i kryer në sistemin informatik të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, në faqen zyrtare të gjykatës në linkun: <https://www.gjykata.gov.al/rrethi-kruje%20C3%AB/gjykata-e-rrethit-kruje%20C3%AB/c%20C3%ABshtjet-gjyq%20C3%ABsore/c%20C3%ABshtjet-penale/>

²⁷ Me shkresën nr. “***” prot., datë 19.1.2023.

87. Në përfundim, nga analiza e dokumentacionit të administruar dhe e vendimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit nuk kanë rezultuar shkelje procedurale që do të mund të përbënin mangësi profesionale të subjektit.

4. Denoncimet nr. “*” prot., datë 8.1.2019 dhe nr. “***” prot., datë 26.6.2019, nga shtetasi P.Ll.**

88. Shtetasi P. Ll. ka paraqitur 2 denoncime ndaj 9 prokurorëve dhe 13 gjyqtarëve, përfshirë edhe subjektin, si dhe një kallëzim penal ndaj tyre duke pretenduar se ata kanë shpërdoruar detyrën dhe kanë fshehur krimin²⁸.

89. Në lidhje me subjektin e rivlerësimit, denoncuesi ka pretenduar se vendimi nr. “***”, datë 30.1.2019 dhe ai me nr. “***”, datë 19.2.2014, të dhëna prej saj, kanë qenë të padrejta.

90. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni ka konstatuar se me vendimin nr. “***”, datë 30.1.2019, subjekti i rivlerësimit ka vendosur rrëzimin e ankimit të shtetasit P. Ll. ndaj vendimit të Prokurorisë “Për pushimin e çështjes penale me nr. “***”, viti 2018”, me arsyetimin se nga ana e organit të akuzës ishin ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme hetimore e verifikuese në funksion të ushtrimit të ndjekjes penale. Vendimi në fjalë është ankimuar nga denoncuesi. Gjatë hetimit, nga Gjykata e Apelit Tiranë është bërë me dije se kjo çështje vijon të jetë në proces përpunimi në këtë Gjykatë²⁹.

91. Për sa i përket vendimit nr. “***”, datë 19.2.2014³⁰, objekt denoncimi, është konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka shpallur moskompetencën lëndore dhe ka dërguar aktet pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Kjo e fundit, me vendimin nr. “***”, datë 30.5.2014, ka vendosur “Shpalljen e moskompetencës tokësore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në gjykimin e çështjes nr. “***” akti. Dërgimin e kërkesëpadisë, së bashku me aktet e paraqitura nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër si gjykata kompetente për gjykimin e kësaj çështjeje”. Në vijim, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, me vendimin nr. s’ka, datë 13.10.2014, ka vendosur të ngrëjë çështjen e mosmarrëveshjes për kompetencën para Gjykatës së Lartë.

92. Me vendimin nr. “***”, datë 13.11.2014, Gjykata e Lartë³¹ ka vendosur se vendimi nr. “***”, datë 30.5.2014, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është rrjedhojë e zbatimit të drejtë të ligjit, prandaj si i tillë ai duhet të lihet në fuqi.

93. Në përfundim të analizimit të të dyja vendimeve të dhëna nga subjekti, ndonëse pretendimi i denoncuesit për dhënie të vendimit të padrejtë del jashtë tagrave të hetimit nga Komisioni, edhe pas kryerjes së një analize të përgjithshme, në aspektin procedural dhe mënyrës së arsyetimit nga subjekti i rivlerësimit, nuk janë evidentuar shkelje apo mangësi profesionale nga ana e saj.

5. Denoncim nr. “*” prot., datë 23.4.2019, i shtetasit M.H.**

²⁸ Kallëzimi është trajtuar edhe në rubrikën “Rivlerësimi nga Komisioni”.

²⁹ Sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Apelit me shkresën nr. “***” prot., datë 19.1.2023, ka bërë me dije se çështja vijon të jetë ende në proces.

³⁰ Gjyqtarja Engjëllushe Tahiri ka qenë anëtare e trupit gjykues në këtë çështje.

³¹ https://www.gjykataelarte.gov.al/gjl_ceshtje_detaje.php?caseId_sel=201405371&ln=Lng1&uni=20230104171402134061106243056293

94. Denoncuesi ka pretenduar se me vendimet nr. “****”, datë 21.9.2018, nr. “****”, datë 8.11.2018 dhe nr. “****”, datë 8.11.2018, subjekti i rivlerësimit ka rrëzuar në mënyrë të padrejtë kërkesëpaditë e tij. Ai ka parashtruar se nuk ankohet për shkelje procedurale, por parashtron shqetësimin e tij se nga subjekti i rivlerësimit Engjëllushe Tahiri nuk janë marrë parasysh kushtet e përcaktuara në kontratat e punës, të cilat ishin dhe objekt gjykimi në proceset gjyqësore të finalizuara në vendimet e sipërcituara.
95. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar është konstatuar se në të tria rastet subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se paditësi nuk kishte depozituar provat mbi të cilat ngrinte pretendimet e tij, megjithëse i ishte bërë me dije ky fakt gjatë procesit. Ajo i ka cilësuar si të pabazuara në ligj e në prova kërkesëpaditë dhe, për rrjedhojë, ka vendosur rrëzimin e tyre.
96. Në përfundim, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar dhe analizimi i vendimeve të dhëna nga subjekti, nisur nga edhe fakti se as nuk janë pretenduar shkelje procedurale nga denoncuesi dhe as nuk janë konstatuar të tilla nga Komisioni, nuk evidentohen rrethana apo fakte që do të ngarkonin subjektin me përgjegjësi në kuadër të vlerësimit profesional të saj.

6. Denoncim nr. “**” prot., datë 6.9.2018, i shtetasit Sh.R.**

97. Denoncuesi ka pretenduar njëanshmëri dhe zvarritje të procesit gjyqësor nga ana e gjyqtarës Engjëllushe Tahiri, në lidhje me çështjen civile nr. “****”, datë 6.6.2017, me objekt “Përmbyshja e një detyrimi kontraktor”, që ka ekzistuar mes palëve, e rrjedhur nga marrëdhënia e punës.
98. Nga shqyrtimi i vendimit dhe procesverbaleve të seancave gjyqësore³² është konstatuar se denoncuesi i është drejtuar fillimisht me kërkesëpadi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me vendimin nr. “****”, datë 21.9.2015, e ka rrëzuar atë, si të pabazuar në ligj e në prova. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. “****”, datë 24.1.2017. Në vijim, shtetasi Sh. R. i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë. Çështja është shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit Engjëllushe Tahiri, e cila me vendimin nr. “****”, datë 12.9.2017, bazuar në nenin 61 të Kodit të Procedurës Civile ka shpallur moskompetencën tokësore dhe ia ka dërguar aktet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit është zhvilluar përgjatë 3 seancave gjyqësore, në intervalin kohor 6.6.2017 – 12.9.2017. Seanca përgatitore është zhvilluar në datën 29.6.2017. Në seancën e radhës, të datës 17.7.2017, është vendosur kalimi i çështjes në seancë gjyqësore.
99. Më pas, shtetasi Sh.R. i është drejtuar me rekurs Gjykatës së Lartë³³, e cila me vendimin nr. “****”, datë 10.1.2018, ka prishur vendimin nr. “****”, datë 12.9.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, me arsyetimin se: *“Në analizë të natyrës së mosmarrëveshjes, shkakut ligjor të saj, objekti të kërkesëpadisë, si dhe kohës së shqyrtimit të saj, Kodi Civil konstaton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë nuk ka zbatuar drejt dispozitat procedurale lidhur me kompetencën tokësore të këtij procesi gjyqësor, duke mos zhvilluar një proces të rregullt ligjor në mbështetje të nenit 42/1*

³² Administruar me shkresën nr. “****” prot., datë 22.11.2022.

³³ https://www.gjykataelarte.gov.al/web/Kerkim_per_Vendime_37_1.php

*të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ-së³⁴; ...në nenin 13 të kontratës individuale të punës, datë 1.9.2009, është parashikuar se gjykata kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ky parashikim nuk mund të zbatohet nga gjykata, pasi bie ndesh me nenet 11 dhe 7/3 të Kodit të Punës dhe nenin 47/1 të Kodit të Procedurës Civile dhe nuk krijon asnjë pasojë juridike për palët. Mosmarrëveshja midis palëve ka lindur pas heqjes së paditësit nga puna në vitin 2014 dhe pas kësaj date nuk ka rezultuar të ketë marrëveshje midis palëve ku të jetë përcaktuar kompetenca tokësore e ndonjë gjykate konkrete. Për sa më sipër, vendimi nr. “***”, datë 12.9.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, duhet të priset e çështja të kthehet në po atë gjykatë për vazhdimin e gjykimit”.*

100. Për sa më sipër, Komisioni, referuar edhe qëndrimin të mbajtur nga Gjykata e Lartë për këtë çështje, i ka kërkuar subjektit të paraqesë shpjegime lidhur me zbatimin e dispozitave procedurale për sa i përket kompetencës tokësore të këtij procesi gjyqësor dhe moszhvillimit të një procesi të rregullt ligjor, kështu duke cenuar të drejtat e palëve në proces.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

101. Subjekti ka parashtruar se në datën 17.4.2015, pala paditëse Sh.R., i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi, duke i kërkuar përmbushjen e detyrimit kontraktor. Pra, në këtë rast, pala paditëse Sh.R., ka zgjedhur të investojë si gjykatë Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, si gjykata kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjes së rrjedhur nga marrëdhënia e punës, sikundër mes palëve ishte përcaktuar në kontratën e punës datë 1.9.2009.
102. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në vendimin nr. “***”, datë 21.9.2015, në faqen e dytë të këtij vendimi konstaton se është kompetente nga pikëpamja tokësore për të shqyrtuar këtë çështje. Në vijim, të njëjtin konstatim bën edhe Gjykata e Apelit Tiranë, në vendimin nr. “***”, datë 24.1.2017, kur disponon për lënien në fuqi të vendimit nr. “***”, datë 21.9.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në të dyja shkallët e gjykimit asnjë nga ndërgjyqësit nuk ka vënë në diskutim çështjen procedurale të kompetencës tokësore.
103. Në datën 6.6.2017, pala paditëse Sh.R., i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë. Nisur nga objekti i padisë dhe shkaku ligjor i saj, pala paditëse Sh. R., ka parashtruar kërkitime që rrjedhin nga e njëjta marrëdhënie pune me palën e paditur, për të njëjtën kontratë individuale pune.
104. Çështja civile e sipërcituar është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 17.4.2015, shumë kohë përpara regjistrimit të çështjes, për të cilën është paraqitur denoncimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, në datën 6.6.2017.
105. Subjekti ka sqaruar se nisur nga faktet e sipërcituara dhe në bazë e për zbatim të nenit 7 të Kodit të Punës, ajo ka krijuar bindjen se palët kanë dakordësuar një marrëveshje pas lindjes së konfliktit, duke përzgjedhur Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë si gjykatë kompetente. Nga ana tjetër, në nenin 467, paragrafi i parë, shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, referuar normës që ka qenë në fuqi në kohën e regjistrimit të çështjes me nr. “***” akti, datë 6.6.2017, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë,

³⁴ Shihni vendimet nr. 23/2009, nr. 7/2009, nr. 31/2005 dhe nr. 16/2012 të Gjykatës Kushtetuese.

parashikohej se: “Gjykata e Apelit prish vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe e dërgon çështjen për rigjykim kur: a) gjykata e shkallës së parë ka shkelur dispozitat mbi juridiksionin dhe kompetencën (...)”. Çështja civile nr. “****” akti, datë 6.6.2017 regjistrimi, për të cilën është paraqitur denoncimi, në çdo rast do të shqyrtohej nga Gjykata e Apelit Tiranë. Kjo e fundit kishte një praktikë konkrete, përmes së cilës njihte si gjykatë kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjes nga marrëdhënia e punës ndërmjet paditësit Sh.R., dhe të paditurit shoqëria “****” sh.p.k.

106. Denoncuesi në fjalë, lidhur me këtë çështje, ka paraqitur ankim edhe pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i cili me vendimin nr. “****” prot., datë 11.10.2022, ka vendosur “1. Arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së ankuesit, z. Sh.R...”.
107. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provave kopje të njësuar me origjinalin të akteve të dosjes gjyqësore nr. “****” regj. them., datë 17.4.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe vendimin nr. “****” prot., datë 11.10.2022, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Vlerësimi i trupit gjykues

108. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të parashtrimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe në mbështetje edhe të qëndrimit të mbajtur nga Gjykata e Lartë për këtë çështje, çmon se sipas rregullimit të përgjithshëm të dispozitës së nenit 52 të Kodit të Procedurës Civile, kompetenca tokësore mund të ndryshohet me marrëveshje me shkrim të palëve, kur këtë nuk e ndalon ligji. Por, sipas dispozitës së posaçme të pikës 3 të nenit 7 të Kodit të Punës, *marrëveshjet që lidhen me juridiksionin janë të vlefshme vetëm nëse përcaktohen pas lindjes së konfliktit*. Pavarësisht se në këtë paragraf përdoret termi “juridiksion”, është e qartë se bëhet fjalë për kompetencën tokësore, ashtu sikurse edhe titullohet vetë neni 7 i Kodit të Punës. Pikërisht, në pikën 3 ligjvënësi e kufizon mundësinë e marrëveshjes mes palëve për caktimin e gjykatës kompetente vetëm në rast se kjo marrëveshje arrihet pas lindjes së konfliktit. Kjo do të thotë që nëse ajo marrëveshje për gjykatën kompetente është përcaktuar me lidhjen e kontratës së punës apo gjatë marrëdhënieve të punës, pra përpara lindjes së konfliktit, modifikimi i mëpasshëm i saj do të ishte një marrëveshje e ndaluar nga ligji – kjo edhe në kuptim të nenit 52 të Kodit të Procedurës Civile.
109. Për sa më sipër, trupi gjykues konkludon se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka gabuar kur për çështjen e gjykatës kompetente nga pikëpamja tokësore i referohet një klauzole të kontratës së punës, që parashikon që në kohën e lidhjes së marrëdhënies së punës se cila do të ishte gjykata kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve mes punëmarrësit dhe punëdhënësit sepse një klauzolë e këtillë është e ndaluar nga ligji. Pra, edhe në çështjen objekt gjykimi, një marrëveshje e tillë është nul dhe, për rrjedhojë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë është gjykata që ka kompetencën tokësore për shqyrtimin e kërkesëpadisë objekt shqyrtimi, përderisa bazuar në nenin 54 paditësi ka ushtruar të drejtën e tij për ta zgjedhur mes gjykatave kompetente që të gjykojë padinë e tij.
110. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se pavarësisht sa është konstatuar e analizuar më sipër, kjo rrethanë e vetme nuk mund të ngrihet në nivelin e ngarkimit të subjektit me përgjegjësi disiplinore.

7. Denoncim nr. “**” prot., datë 27.12.2018, i shtetasit M. B.**

111. Denoncuesi ka pretenduar se vendimi nr. “****”, datë 24.9.2018, i dhënë nga subjekti i rivlerësimit Engjëllushe Tahiri, me objekt “Anulimi i vendimit nr. “****”, datë 19.4.1996, të KKKP Krujë”, është i padrejtë, pasi është marrë duke u bazuar në vendimin e sipërcituar të KKKP-së.
112. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar³⁵ është konstatuar se subjekti i rivlerësimit, përgjatë procesit gjyqësor, ka urdhëruar kryerjen e një akti ekspertimi topografik, me anë të të cilit është konkluduar se referuar dokumentacionit, si dhe verifikimeve në terren, nuk ka rezultuar asnjë dokument që të vërtetonte se prona e pretenduar nga shtetasi M. B. të kishte pësuar ndryshime përgjatë viteve 1939 – 1946. Në vendim citohet se ekspertja i është referuar akteve të kufitarëve, pasi hartat/skicat e vitit 1951 mungonin – dhe ka arritur në përfundimin se me gjithë investimin e gjykatës për administrimin e dokumenteve nga institucionet shtetërore ishte e pamundur të përcaktohej pozicionimi i qartë i pasurisë së pretenduar nga pala paditëse. Referuar dokumenteve të vëna në dispozicion nga institucionet përkatëse pas investimit të gjykatës, ishte gjithashtu e pamundur për ekspertin të përcaktonte pozicionimin e pasurisë objekt shqyrtimi gjyqësor. Subjekti i rivlerësimit Engjëllushe Tahiri ka arsyetuar gjithashtu se pretendimet e palës paditëse për mbivendosje të pronës me pasurinë e palëve të paditura dhe anulim të vendimit nr. “****”, datë 19.4.1996, të KKKP Krujë, rezultuan të pabazuara në ligj e në prova e, për rrjedhojë, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Në vijim³⁶ ka rezultuar se paditësi ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, në të cilën çështja vijon të jetë në proces shqyrtimi.
113. Për sa më sipër, nisur nga sa është disponuar, nuk janë konstatuar shkelje procedurale, cenim i të drejtave të palëve apo mangësi në arsyetimin e vendimit nga ana e subjektit të rivlerësimit. Pretendimet e denoncuesit lidhen thelbësisht me themelin e çështjes, e cila vijon të jetë objekt shqyrtimi nga Gjykata e Apelit Tiranë, sikurse kjo e fundit ka bërë me dije³⁷, dhe shkojnë përtej juridiksionit të organeve të rivlerësimit kalimtar.

8. Denoncim nr. “**” prot., datë 17.8.2018, i shtetasit Xh.C.**

114. Denoncuesi ka ngritur pretendime për njëanshmëri dhe zvarritje të procesit gjyqësor, në të cilin subjekti ka qenë anëtare e trupit gjykues të çështjes, në lidhje me një aksident automobilistik, si pasojë e të cilit kishte humbur jetën bashkëshortja e tij.
115. Nga dokumentacioni i administruar është konstatuar se organi i prokurorisë kishte urdhëruar kryerjen e aktit të ekspertimit, i cili është kryer në datën 25.10.2016 dhe është konkluduar se shkaku determinant i ardhjes së pasojës/vdekjes së këmbësorës kishte qenë shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor nga ana e këmbësorit/viktimës. Për sa i përket shpejtësisë së automjetit që kishte shkaktuar aksidentin, nga të dyja aktet e ekspertimit ishte konkluduar se automjeti kishte lëvizur brenda normave të lejuara të shpejtësisë. Në përfundim të hetimit, me vendimin nr. “****”, prokuroria kishte vendosur pushimin e procedimit penal, me arsyetimin se mungonin elementet e veprës penale “shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni

³⁵ Përcjellë pranë Komisionit me shkresën nr. “****” prot., datë 22.11.2022.

³⁶ Po aty, referuar dëftesës së datës 8.11.2018, të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë.

³⁷ Me shkresën nr. “****” prot., datë 19.1.2023.

290 i Kodit Penal dhe as përpara kryerjes së ndonjë vepre tjetër penale, siç mund të jetë ajo e drejtimit të parregullt apo largimit nga vendi i aksidentit, parashikuar nga nenet 291 dhe 273 të Kodit Penal. Ndaj këtij vendimi ka paraqitur ankim në gjykatë shtetasi Xh. C., i cili, ndër të tjera, ka kërkuar edhe përsëritjen e ekspertimit autoteknik, me një grup tjetër ekspertësh. Këta ekspertë, me aktin e datës 27.12.2016³⁸, kanë arritur në të njëjtin konstatim me atë të sipërpërkthuar. Në këto kushte, trupi gjykues, me vendimin nr. “****” akti, datë 17.7.2017, ka vendosur rrëzimin e kërkesës penale me nr. “****” akti, të kërkuarit Xh. C., me objekt “Shfuqizimi i vendimit të pushimit e procedimit penal nr. “****””, si të pambështetur në ligj dhe në prova. Ky vendim është mbështetur nga Gjykata e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. “****”, datë 22.5.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë.

116. Lidhur me pretendimin e denoncuesit për zvarritje të procesit gjyqësor, nga verifikimi i indeksit alfabetik të çështjeve penale³⁹, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë është konstatuar se çështja është regjistruar në datën 20.1.2017 dhe vendimi është dorëzuar në sekretarinë e gjykatës në datën 20.7.2017. Gjykimi ka përfunduar për 6 muaj, pra kohëzgjatja e gjykimit të kësaj çështjeje ka qenë brenda afatit 12-mujor të përcaktuar në pikën 5, shkronja “a” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit⁴⁰.
117. Për sa i përket pretendimeve të denoncuesit për njëanshmëri, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, por edhe duke mbajtur në vëmendje se vendimi në fjalë, që është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit, si dhe fakti që subjekti në këtë vendimmarrje nuk ka qenë e vetme, por anëtare e trupit gjykues, nuk janë evidentuar shkelje të të drejtave të palëve apo shkelje procedurale të tjera, që do të ngarkonin subjektin me përgjegjësi.

9. Denoncim nr. “**” prot., datë 3.6.2019, i shtetasit R.M.**

118. Shtetasi R. M. ka përmendur disa gjyqtarë, e ndërmjet tyre edhe subjektin Engjëllushe Tahiri, duke pretenduar ndaj kësaj të fundit se ka marrë një vendim të njëanshëm, jo profesional dhe të pabazuar në prova.
119. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar është konstatuar se me kërkesën e datës 12.10.2021, prokuroria ka kërkuar pushimin e procedimit penal nr. “****”, datë 31.12.2018, për veprën penale “ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a/1 i Kodit Penal, me arsyetimin se mungojnë elementet e veprës penale.
120. Në vijim, çështja është shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit, e cila, ndër të tjera, ka parashtruar në vendim se gjatë seancës kallëzuesi R. M., kishte paraqitur disa prova të reja. Gjithashtu, referuar pretendimeve të kallëzuesit, si dhe provave të paraqitura prej tij, prokurori i çështjes kishte kërkuar kthimin e çështjes për rihetim. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. “****”, datë 4.7.2019⁴¹, ka vendosur pranimin e kërkesave të tyre dhe kthimin e çështjes për rihetim. Vendimi në fjalë ka marrë formë të prerë në datën 5.8.2019.

³⁸ Ekspertimi është përsëritur për shkak se shtetasi Xh. C. ka pretenduar se grupi i parë i ekspertëve nuk ka pasur në dispozicion aktin e ekspertimit mjekoligjor dhe deklaratimet e shtetasve që kanë parë ngjarjen.

³⁹ Përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me shkresën nr. “****” prot., datë 22.11.2022.

⁴⁰ Sistemi i Vlerësimit përmbledh vendimin nr. “****”, datë 14.4.2010, të KLD-së “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve”, së bashku me Aneksin I “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

⁴¹ Me shkresën nr. “****” prot., datë 22.11.2022.

121. Për sa më sipër, pretendimet e denoncuesit kanë rezultuar në nivel deklarativ dhe të pabazuara në fakte. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, ndër të tjera, edhe të procesverbaleve të seancave të kësaj çështjeje, nuk janë konstatuar shkelje procedurale apo të të drejtave të palëve nga ana e subjektit të rivlerësimit.

10. Denoncim nr. “**” prot., datë 23.2.2018, i shtetasit Rr. K.**

122. Denoncuesi ka pretenduar se vendimi nr. “****” akti, datë 3.10.2012, i dhënë nga subjekti i rivlerësimit Engjëllushe Tahiri, me të cilin ishte vendosur rrëzimi i kërkesës së shtetasit K. Kola, ka qenë në kundërshtim me vendimin nr. “****”, datë 24.1.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për çështjen me të njëjtin objekt, të përfunduar me vendimin nr. “****”, datë 18.2.2011, për shkak të konstatimit të moskompetencës.

123. Nga aktet e administruara ka rezultuar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër kishte pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të dënimit të mbetur të shtetasit K. K., i dënuar sipas vendimit nr. “****”, datë 2.9.1987, me 25 vite burgim, për veprën penale “vrasje me dashje” dhe kryerjen e pjesës së mbetur të dënimit me “qëndrimin e tij në shtëpi”, bazuar në nenin 59/a të Kodit Penal, duke mbajtur kontakte me shërbimin e provës. Ky vendim është prishur për shkak të konstatimit të moskompetencës.

124. Më pas, me vendimin nr. “****” akti, datë 3.10.2012, subjekti i rivlerësimit ka vendosur rrëzimin e kërkesës, pasi nuk plotësoheshin kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 59/a të ligjit penal të kohës nr. “****”, datë 27.11.2008, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

125. Gjatë gjykimit të kësaj çështjeje, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar kryerjen e ekspertimit të gjendjes shëndetësore të kërkuesit, duke kërkuar nga policia edhe shoqërimin e detyrueshëm të tij, por kjo nuk është bërë e mundur, për shkak se i dënuari ka refuzuar.

126. Nga analizimi i dokumentacionit të administruar ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, gjatë shqyrtimit të kërkesës në fjalë, ka hetuar në lidhje me historikun e gjendjes shëndetësore të të pandehurit dhe ka konkluduar se kushtet e tij shëndetësore nuk kanë qenë të atilla sa të mos mundësonin vijimin dhe vazhdimin e qëndrimit të tij në vendin e vuajtjes së dënimit, pasi i është mundësuar mjekimi pranë këtij institucioni. Nëse këto kushte kishin ndryshuar, sipas gjykatës i takonte kërkuesit ta vërtetonte atë.

127. Në përputhje me nenet 367 dhe 378/5 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti i rivlerësimit ka marrë si provë raportin e kryer nga Shërbimi i Provës, në të cilin është parashtruar se është e pamundur të përcaktohet gjendja shëndetësore e të dënuarit, për shkak të mosbashkëpunimit të tij. Në vlerësim të gjykatës, moshë e të pandehurit dhe gjendja shëndetësore e tij përbënin dy kushte kumulative të nevojshme për aplikimin e nenit 59/a të Kodit Penal. Duke mos u provuar gjendja shëndetësore e kërkuesit, i cili ka pasur barrën e provës, kjo dispozitë nuk mund të aplikohet e, për rrjedhojë, gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës së tij, si të pambështetur në prova e në ligj.

128. Ndaj këtij vendimi ka paraqitur ankim shtetasi K. K., i cili ka pretenduar aplikimin e dënimit alternativ, sipas nenit 59/a/c/ç të Kodit Penal. Në seancën e zhvilluar në datën 6.3.2013, në Gjykatën e Apelit, prokurori ka kërkuar prishjen e vendimit dhe pushimin e gjykimit, për shkak se kërkuesi kishte ndërruar jetë. Në këto kushte, Gjykata e Apelit Tiranë, bazuar në nenin 328/c të Kodit të Procedurës Civile, me vendimin nr. “****”, datë 6.3.2013, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe pushimin e çështjes.
129. Në përfundim të shqyrtimit dhe analizimit të sa më sipër, Komisioni mban në vëmendje se lloji dhe masa e dënimit ndaj një të pandehuri duhet të përcaktohet brenda kornizave ligjore, sipas bindjes së brendshme të gjyqtarit të çështjes, duke vlerësuar me objektivitet provat e administruara gjatë procesit gjyqësor, si dhe në përputhje me procedurën e përcaktuar në dispozitat ligjore. Në këtë rast, për sa kohë lloji dhe masa e dënimit të dhënë kanë qenë brenda kufijve të përcaktuar nga dispozitat përkatëse, çmohet se në mungesë të fakteve që provojnë të kundërtën nuk mund të konkludohet për favorizim apo rëndim të pozicionit të palëve ndërgjyqëse dhe vlerësimi nëse masa e dënimit apo vendimmarrja mbi zgjidhjen në themel të çështjes kanë qenë të drejta ose jo, del jashtë juridiksionit të organeve të rivlerësimit. Gjithashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni lidhur me këtë çështje, nuk janë konstatuar shkelje procedurale apo të të drejtave të palëve nga ana e subjektit të rivlerësimit.

11. Denoncim nr. “**” prot., datë 15.11.2018, i shtetasit M.G.**

130. Denoncuesi ka përmendur disa prokurorë e gjyqtarë, ndërmjet tyre edhe subjektin e rivlerësimit, për të cilën ka pretenduar dhënie të vendimit në kundërshtim me ligjin. Pretendimi i tij i referohej vendimeve nr. “****”, datë 13.3.2014 dhe nr. “****”, datë 9.9.2015, të dhëna nga subjekti i rivlerësimit.
131. Nga shqyrtimi i vendimit nr. “****”, datë 13.3.2014⁴², është konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar moskompetencën lëndore dhe ka dërguar aktet në Gjykatën Administrative. Në vijim, pas ankimit të veçantë të palës paditëse I.G., Gjykata e Lartë⁴³, me vendimin nr. “****”, ka vlerësuar se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë është dhënë në zbatim të drejtë të ligjit procedural e material e, për rrjedhojë, duhet të lihej në fuqi.
132. Gjithashtu, ankuesi ka ngritur pretendime edhe ndaj vendimit nr. “****”, datë 9.9.2015, të dhënë nga subjekti i rivlerësimit Engjëllushe Tahiri. Me anë të këtij vendimi, subjekti i rivlerësimit ka vendosur rrëzimin e kërkesës së paditësit për prishjen e vendimit të pushimit të prokurorisë.
133. Nga aktet ka rezultuar se lidhur me këtë çështje prokuroria kishte kërkuar pushimin e procedimit penal nr. “****”, për veprat penale “ndërtim i paligjshëm”, “falsifikim i

⁴² Referuar shkresës nr. “****” prot., datë 22.11.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

⁴³ Referuar qëndrimin të mbajtur në vendimin unifikues nr. 4, datë 10.12.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë lidhur me përcaktimin e natyrës së mosmarrëveshjes në kërkesëpadi me kërtime të ndërvarura, ku është arritur në sentencën unifikuese se: “...Kur në objektin e gjykimit ka disa kërtime si të natyrës civile dhe administrative dhe këto kërtime konstatohet nga gjykata se janë një bashkim i ndërvarur mes tyre, atëherë referuar nenit 55 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 24 të ligjit nr. 49/2012 dhe zbatimit të parimit *lex specialis derogat generali*, gjykata kompetente është si më poshtë: kur në objektin e gjykimit pala paditëse, ndër të tjera, ka për objekt kundërshtimin e një akti administrativ dhe nga pasojat e aktit prodhohen pasoja civile, në çdo rast kompetente është gjykata administrative...”

dokumenteve” dhe “shpërdorim detyre”, parashikuar nga nenet 199/a, 186 dhe 248 të Kodit Penal.

134. Në vendimmarrjen e saj, znj. Engjëllushe Tahiri, ndër të tjera, ka arsyetuar se fakti që paditësi nuk ka qenë dakord me deklaratimet dhe rezultatet e aktit të ekspertimit të datës 13.5.2014, duke mos parashtruar se cilat ishin veprimet që nuk kishte kryer organi i akuzës apo kundërthëniet e deklaruesve, nuk e bën të cënueshëm vendimin e dhënë nga prokurori.
135. Gjithashtu, subjekti ka parashtruar se e gjithë mosmarrëveshja e palëve lidhej me pretendimet për të drejtën e pronësisë mbi një sipërfaqe toke, për të cilën palët vijonin të ishin në procese gjyqësore civile dhe administrative – dhe që për to nuk kishte ende një vendim të formës së prerë. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit ka vlerësuar se pretendimet e kërkuarit ishin të pabazuara në prova e në ligj e, për rrjedhojë, kërkesa e tij duhej rrëzuar.
136. Vendimi në fjalë është ndryshuar me vendimin nr. “****”, datë 26.9.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila ka vlerësuar se kërkesa për prishjen e vendimit të pushimit të prokurorisë duhet të pranohej dhe të vazhdonin hetimet nga prokuroria. Gjithashtu, ajo ka arsyetuar se hetimi nga prokuroria nuk ishte i plotë dhe i gjithanshëm. Në përfundim, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur ndryshimin e vendimit të dhënë nga subjekti në këtë mënyrë: *Pranimin e kërkesës për prishjen e vendimit të prokurorisë dhe kthimin e çështjes për rihetim*. Ndaj këtij vendimi është paraqitur rekurs dhe Gjykata e Lartë, me vendimin nr. “****”, datë 30.3.2017, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se rekursi nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale.
137. Për sa më sipër, referuar edhe qëndrimit të mbajtur nga Gjykata e Apelit për këtë çështje, Komisioni e ka ftuar subjektin të paraqesë shpjegime lidhur me mosevidentimin e mungesës së hetimeve të nevojshme që duheshin kryer nga prokuroria, duke pranuar pushimin e çështjes në fjalë me hetime të paplota dhe në rrethana të paqarta.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

138. Subjekti ka parashtruar se nga aktet e dosjes gjyqësore ka rezultuar se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, në datën 28.1.2014, ka vendosur kryerjen e aktit të ekspertimit topografiko-urbanistik, duke caktuar një grup ekspertësh. Në faqen 10 të aktit të ekspertimit, ose faqja 184 e dosjes gjyqësore, Prokuroria i shtron për zgjidhje ekspertëve këtë pyetje: A i është shkaktuar ndonjë dëm konkret objektit në pronësi të shtetasit M.G.,? Lidhur me këtë pyetje, ekspertët shprehen se nuk ka ndonjë dokument pronësie të shtetasit M.G.
139. Nga ana tjetër, referuar akteve të dosjes gjyqësore rezulton që në fazën e hetimit Prokuroria ka pyetur personat kundër të cilëve është paraqitur kallëzimi penal nr. “****”, datë 18.7.2013 dhe secili prej tyre ka dhënë sqarimet përkatëse rreth faktit penal të pretenduar nga kallëzuesi. Në vendimin e saj Gjykata e Apelit nuk përcakton se cili person tjetër duhet të ishte pyetur.
140. Për sa më sipër, veprimet hetimore për të cilat Gjykata e Apelit ka disponuar me prishjen e vendimit të pushimit dhe kthimin e çështjes për rihetim në të vërtetë janë

kryer nga ana e organit të akuzës. Pra, hetimi i kësaj çështjeje, në të gjitha drejtimet ka qenë i plotë e i gjithanshëm. Për këtë arsye, edhe qëndrimi i prokurorit të Apelit dhe kërkesa e tij ka qenë për lënien në fuqi të vendimit nr. “****”, datë 9.9.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë⁴⁴.

141. Subjekti ka shpjeguar gjithashtu se për secilën nga veprat penale, objekt kallëzimi, ajo ka bërë një analizë të detajuar të elementeve të veprës penale, siç paraqitet në mënyrë të shtjelluar në vijim.
142. Konkretisht, lidhur me veprën penale “ndërtim pa leje”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, subjekti ka arsyetuar se ligjvënësi ka amnistuar të gjitha ndjekjet penale për veprën penale të parashikuar, pavarësisht masës dhe llojit të dënimit, mjafton që fakti penal të jetë kryer përpara datës 10.4.2013. Në rastin konkret, kallëzimi penal është regjistruar në datën 14.10.2013 dhe për të cilin kallëzuesi pretendon se ndërtimi ka nisur në vitin 2012. Pra, përmbushen elementet e nenit 5 të ligjit nr. 22/2014, sipas ndryshimeve me ligjin nr. 92.2015 dhe, për pasojë, të amnistisë nga ndjekja penale.
143. Lidhur me veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, subjekti është shprehur se nga aktet ka rezultuar se me vendimin datë 13.12.2011, të kryetarit të Bashkisë Krujë, është vendosur dhënia e lejes për subjektin “****” sh.p.k., për ndërtimin e një godine, garazhi, njësie shërbimi dhe banimi, leje kjo e cila nuk është zbardhur dhe për të nuk është përfunduar e gjithë procedura administrative që parashikonte ligji i posaçëm, ndërsa në vijim ajo është anuluar me vendim të kryetarit të Bashkisë Krujë. Në këto kushte, nuk mund të konkludohet në ekzistencën e të gjitha elementeve të kësaj vepre penale apo minimalisht në mungesën e anës subjektive në ndërmarrjen e veprimeve.
144. Lidhur me pretendimin e kallëzuesit se punonjësit e ZVRPP-së kanë kryer veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, për regjistrimin e pasurisë së shtetasit B.K., subjekti argumenton se gjatë hetimit ka rezultuar se ky regjistrim është kryer bazuar në kontratën e shitjes ndërmjet tij dhe shtetasit M.K., me nr. “****” rep., nr. “****” kol., datë 21.12.1999, ndërsa shtetasi M.K., e ka fituar pronën me kontratë shitjeje nga ish-pronarja F.M. Pra, regjistrimi i pronës nga punonjësit e ish-ZVRPP-së Krujë është kryer bazuar në kontratat noteriale që janë paraqitur nga subjektet e interesuara. Për këtë arsye, ata nuk mund të kenë përgjegjësi penale sepse kanë zbatuar ligjin dhe detyrat që u janë ngarkuar.
145. Lidhur me veprën penale “falsifikim dokumentesh”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, sipas subjektit ka rezultuar se në kallëzimin penal është pretenduar se noterja M.S., ka falsifikuar lejen e ndërtimit në favor të shoqërisë “****” sh.p.k. Sikundër u përmend edhe më lart, leja e ndërtimit është dhënë nga kryetari i Bashkisë Krujë dhe nuk ka qenë e zbardhur, pasi nuk është përfunduar e gjithë procedura administrative që parashikonte ligji i posaçëm. Ndërsa, në vijim, ajo është anuluar me vendim të kryetarit të Bashkisë Krujë. Pra, në këtë rast ekziston një dokument i lëshuar nga organi kompetent shtetëror dhe të dhënat e paraqitura nuk kanë qenë të rreme.
146. Në ankimin e tij kallëzuesi përmend edhe vendimin nr. “****”, datë 18.5.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila ka vendosur “Pranimin e

⁴⁴ Konkluzione me shkrim, faqja 14 e në vijim e dosjes gjyqësore të Gjykatës së Apelit.

kërkesëpadi së paraqitur nga paditësi I.G.; detyrimin e palës së paditur, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Krujë, që të bëjë çregjistrimin e pjesës për pasurinë nr. “****”, për sipërfaqen 160 m² dhe të pasurisë nr. “****”, për sipërfaqen 80 m² (gjithsej 240 m²) të regjistruar në emër të të paditurit Bashkim Kullaj”. Kundër këtij vendimi është paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila, me vendimin nr. “****”, datë 21.9.2017, ka vendosur “Prishjen e vendimit nr. “****”, datë 18.5.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pushimin e gjykimit të çështjes”. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. “****”, datë 15.11.2021, ka vendosur “Mospranimin e rekursit të palës paditëse I.G., dhe personit të tretë M. G., kundër vendimit nr. “****”, datë 21.9.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit”. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. “****”, datë 1.11.2022, ka vendosur “Rrëzimin e kërkesës. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare”⁴⁵.

Vlerësimi i trupit gjykues

147. Pas analizimit të parashtrimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, në mbështetje edhe të qëndrimit unifikues të mbajtur nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin nr. 2, datë 20.6.2013, ku, ndër të tjera, argumentohet se: *“Në rast se në ankimin kundër vendimit të pushimit të çështjes janë treguar veprime hetimore që sipas ligjit duhet të ishin bërë, por nuk janë kryer, është e kuptueshme që – kur kërkimet e ankuesit kanë të bëjnë me kryerjen nga ana e prokurorisë të veprimeve të tjera hetimore, të cilat vlerësohen si të domosdoshme për arritjen e një konkluzioni të drejtë në drejtim të ngritjes ose jo të një akuze – gjykata duhet të urdhërojë prokurorin edhe për kryerjen e këtyre veprimeve hetimore shtesë...”*, si dhe qëndrimit të mbajtur nga Gjykata e Lartë në vendimin nr. 713, datë 16.12.2009, në të cilin citohet se: *“...nëse gjykata vlerëson se veprimet e kryera nga organi i akuzës pamundësojnë arritjen e një konkluzioni, pra janë të mangëta e të paplota, ajo ka tagrin të prishë vendimin e prokurorit dhe ta urdhërojë atë të ndërmarë veprime të tjera”*, trupi gjykues çmon se gjykata shndërrohet në garantin e kontrollit të veprimtarisë hetimore të prokurorisë vetëm në aspekt të verifikimit të “mjaftueshmërisë së veprimeve hetimore” të ndërmarra nga prokurori, pa shqyrtuar në themel çështjen konkrete, për të arritur në konkluzionin nëse hetimet e kryera nga prokuroria janë apo jo të plota, pra të atilla sa nga tërësia e tyre të mund të konkludohet në një përfundim të caktuar.
148. Në rastin konkret ka rezultuar se veprimet hetimore të “nevojshme”, në vlerësim të gjykatës, bazuar në normat procedurale që gjenin zbatim në rastin konkret, si dhe bazuar në bindjen e brendshme të saj, sikurse ajo ka deklaruar, kanë rezultuar të “mjaftueshme”, në kontekst dhe në harmoni me vendimet unifikuese të sipërcituara.
149. Për sa më sipër, Komisioni çmon se gjykimi apo vlerësimi mbi zgjidhjen e një çështjeje gjyqësore në themel, duke gjykuar e vlerësuar logjikën apo bindjen e brendshme të subjektit të rivlerësimit të formuar dhe të shpalosur si pjesë e

⁴⁵ Subjekti ka paraqitur kopje të njësuar me origjinalin të dosjes gjyqësore dhe asaj hetimore për rastin në fjalë, vendimin nr. “****”, datë 15.11.2021, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë dhe vendimin nr. 24/2022 të Gjykatës Kushtetuese, aksesuar nga faqja zyrtare e kësaj gjykate.

vendimmarrjes përkatëse, duke kryer vlerësim dhe arsyetim mbi provat, si dhe mbi të gjitha rrethanat e çështjes së gjykuar, mund të kryhet vetëm nga një tjetër gjykatë e legjitimuar dhe jo nga organet e rivlerësimit. Kësisoj, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni, lidhur me këtë çështje, nuk janë konstatuar shkelje procedurale apo të të drejtave të palëve nga ana e subjektit të rivlerësimit.

12. Denoncim nr. “***” prot., datë 12.12.2019, i shtetases N.A.**

150. Denoncuesja ka pretenduar se me vendimin nr. “*****”, datë 21.11.2019, subjekti i rivlerësimit Engjëllushe Tahiri ka rrezuar në mënyrë të padrejtë kërkesën e saj për të përfituar pension pleqërie.
151. Nga shqyrtimi i vendimit në fjalë, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar ndër të tjera se kërkesja nuk kishte mbushur moshën për pension pleqërie e, për rrjedhojë, nuk kishte interes të ligjshëm dhe aktual nga i cili varet e drejta ligjore e pretenduar, për rrjedhojë ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Gjatë procesit të rivlerësimit, Gjykata e Apelit Tiranë ka bërë me dije se ndaj vendimit objekt denoncimi ka paraqitur ankim shtetasja N. A. dhe çështja vijon të jetë në proces përpunimi në këtë Gjykatë⁴⁶.
152. Në përfundim të analizimit të materialit të administruar nga Komisioni dhe të vendimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, nuk janë konstatuar *indicie* për hetim të thelluar, për sa kohë pretendimi lidhet me themelin e çështjes.

13. Denoncim nr. “***” prot., datë 30.3.2018, i shtetasit Sh.M.**

153. Denoncuesi ka ngritur pretendime ndaj disa gjyqtarëve, ndërmjet tyre edhe ndaj subjektit të rivlerësimit Engjëllushe Tahiri. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni përgjatë procesit të rivlerësimit⁴⁷, ka rezultuar se denoncuesi ka qenë në cilësinë e personit të tretë në procesin gjyqësor me objekt “Kthimi i pronës”, ku nëna e tij ka qenë paditëse dhe i paditur ka qenë shtetasi E. K. Çështja në fjalë është shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit, e cila me vendimin nr. “*****”, datë 15.7.2013, ka arsyetuar ndër të tjera se paditësja nuk legjitimohej në kërkesën e saj për shkak se prona e pretenduar nuk ekzistonte më – dhe se personi i tretë Sh. M., duhet t’i drejtohej gjykatës me një padi të re për rivendikimin e sendit të paluajtshëm, për të cilin pretendonte të drejta pronësie. Vendimi i dhënë nga subjekti i rivlerësimit ka marrë formë të prerë në datën 13.8.2013. Gjykata e Apelit Tiranë me të njëjtin arsyetim, me vendimin nr. “*****”, datë 12.3.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. “*****”, datë 8.4.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë. Ndaj vendimit të sipërcituar rezulton të ketë paraqitur rekurs paditësi Sh.M., i cili ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. “*****”, datë 12.3.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendimit nr. “*****”, datë 8.4.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe pranimin e padisë. Në vijim, shtetasi Sh.M., me kërkesën nr. “*****” prot., datë 28.9.2018, ka kërkuar “heqjen dorë nga rekursi” bazuar në nenin 490 të Kodit të Procedurës Civile. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. “*****”, ka vendosur mospranimin e rekursit.

⁴⁶ Me shkresën nr. “*****” prot., datë 19.1.2023, Gjykata e Apelit ka bërë me dije se çështja vijon të jetë ende në proces përpunimi.

⁴⁷ Me shkresën nr. “*****” prot., datë 16.3.2023.

154. Nga sa më sipër, ka rezultuar se nuk janë evidentuar shkelje procedurale apo favorizim i palës në procesin gjyqësor. Subjekti i rivlerësimit e ka orientuar shtetasin Sh. M., për rrugën ligjore që duhet të ndiqte për të drejtën e pretenduar prej tij.
155. Po në këtë denoncim, shtetasi Sh. M., është shprehur se subjekti i rivlerësimit ka në pronësi dy apartamente të ndodhura në zonën e quajtur Unaza e Re, Tiranë, si dhe një automjet tip “Ford” me targë “****””. Sipas denoncuesit, këto pasuri gjyqtares ia ka blerë një biznesmen, i cili ka qenë palë në një proces gjyqësor me denoncuesin dhe që është favorizuar nga subjekti i rivlerësimit Engjëllushe Tahiri.
156. Lidhur me faktet e denoncuar që i referohen pasurive të mundshme të subjektit të rivlerësimit, bazuar në të dhënat e paraqitura nga denoncuesi, ka rezultuar se pasuria e ndodhur në zonën e quajtur Unaza e Re, Tiranë, përkon me adresën e apartamentit në bashkëpronësi të subjektit dhe familjes së saj (analizuar në pikën 1 të këtij vendimi).
157. Megjithatë, me qëllim verifikimin e ndonjë pasurie të mundshme në emër të subjektit, veç atyre të sipërcituara, nga hetimi administrativ (ASHK, RNSH, FSHU, UKT, bankat e nivelit të dytë etj.), si dhe nga verifikimi në sistemin *online* të ASHK-së në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të, nuk ka rezultuar porositja/blerja apo kryerja e ndonjë pagese për pasuri të tjera të mundshme. Nga verifikimi *online* i kryer nga Komisioni në regjistrin elektronik të QKB-së, për shtetasin në fjalë, nuk ka rezultuar ndonjë shoqëri tregtare e regjistruar me emër të shtetasit E.K., dhe as nuk ka rezultuar si aksioner apo ortak i ndonjë shoqërie tregtare. Gjithashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar⁴⁸ lidhur me godinën ku ndodhet apartamenti në pronësi të subjektit të rivlerësimit, shtetasi E. K., nuk ka rezultuar të jetë as pronar truall dhe as administrator/aksioner/ortak në shoqërinë që ka ndërtuar këtë pallat. Kësisoj, dyshimi/pretendimi i ngritur nga denoncuesi dhe informacionet e përcjella prej tij nuk kanë gjetur konfirmim nga hetimi i Komisionit.
158. Për sa i përket automjetit, që sipas denoncuesit është i tipit “Ford”, me targë “****””, sikurse është trajtuar në pasurinë nr. “****”” në këtë vendim, subjekti ka në pronësi një automjet të të njëjtit tip, por me targë “****””. Nga hetimi administrativ (RNSH, si dhe nga verifikimi në sistemin *online* të AMF-së), në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të nuk ka rezultuar porositja/blerja apo kryerja e ndonjë pagese për tjetër pasuri të mundshme, të llojit automjet.
159. Nga sa më sipër, ndonëse nga Komisioni u ndërmorën veprimet verifikuese dhe hetimore të sipërpërkshkruara, nuk rezultoi që subjekti të kishte në posedim/përdorim apo pronësi ndonjë apartament tjetër apo automjet, veç atyre të deklaruara nga vetë subjekti i rivlerësimit.

14. Denoncim nr. “**”” prot., datë 19.9.2018, i shtetasit A.H.⁴⁹**

160. Denoncuesi ka përmendur tre gjyqtare, ndërmjet tyre edhe subjektin e rivlerësimit. Pretendimet e tij ndaj gjyqtares Engjëllushe Tahiri i referohen vendimit të dhënë prej saj, me nr. “****””, datë 21.7.2015, për çështjen me objekt “Zgjidhja e pasojave të deklarimit të pavlefshëm të kontratës së *overdraftit*”.

⁴⁸ Me shkresën nr. “****”” prot., datë 10.5.2023.

⁴⁹ Denoncim i përcjellë nga ONM-ja me nr. “****”” prot., datë 23.4.2019.

161. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar ka rezultuar se gjatë gjykimit kishte rezultuar e provuar se mes palëve (denoncuesit dhe BKT-së) kishte pasur një marrëdhënie juridiko-civile të formalizuara me kontratë huaje. Subjekti i rivlerësimit Engjëllushe Tahiri, bazuar në rrethanat e konstatuara gjatë hetimit gjyqësor, si dhe bazuar në dispozitat ligjore që gjejnë zbatim në rastin konkret, ka arsyetuar ndër të tjera se në një marrëdhënie juridiko-civile janë palët të cilat me vullnetin e tyre dakordësojnë përmbajtjen e kontratës brenda kufijve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Kjo kontratë, nga analiza e gjykatës, ka rezultuar në përputhje me kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 663 të Kodit Civil. Fakti që paditësi ka qenë në pamundësi për të përmbushur detyrimet që buronin nga kontrata, nuk e bënte këtë kontratë dhe detyrimet që buronin prej saj të pavlefshme. Me këtë arsyetim, subjekti ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në prova e në ligj.
162. Në vijim, Gjykata e Apelit, me vendimin nr. “*****”, datë 16.11.2016, e ka vlerësuar të cënueshëm vendimin, dhënë nga subjekti, dhe e ka kthyer në gjykatën e shkallës së parë për t’u gjykuar nga një tjetër trup gjykues. Gjykata e Apelit ka arsyetuar se gjykata e shkallës së parë kishte disponuar me vendim, i cili nuk u përgjigjet rrethanave të provuara, duke mos e sqaruar paraprakisht natyrën e konfliktit në gjykim. Gjithashtu, sipas saj (Gjykata e Apelit), gjykata e shkallës së parë duhet të kishte arsyetuar: (i) ndikimin e zgjidhjes së marrëdhënies së punës në raport me kontratën e kredisë së paditësit (me palën e paditur BKT); (ii) ekzistencën e detyrimeve të paditësit; (iii) mënyrën e përlllogaritjes së interesave; si dhe (iv) moslëvizjen e përfitimit të kredisë gjatë kësaj periudhe – në mënyrë që të arrinte në një përfundim të saktë lidhur me pretendimet e paditësit për një detyrim më të vogël.
163. Pasi është rikthyer për gjykim në gjykatën e shkallës së parë, çështja ka rezultuar e gjykuar nga një tjetër gjyqtare, e cila, gjithashtu – në përfundim të shqyrtimit të akteve të ndodhura në dosjen nr. “*****”, datë 21.7.2015, si dhe pas dëgjimit të pretendimeve të palëve – ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në prova e në ligj.
164. Në përfundim, lidhur me sa është shqyrtuar e analizuar më sipër, Komisioni, pa dashur të vlerësojë mbi themelin e çështjes, ka konkluduar se bazuar në nenin 72 të ligjit nr. 96/2016, në të cilin përcaktohet se “*Aspekti i arsyetimit ligjor të gjyqtarëve në marrjen e vendimeve vlerësohet duke u bazuar në tregues të tillë si qartësia dhe kuptueshmëria e vendimit, struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e vendimit, si dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik*”, konstaton se – duke mbajtur në vëmendje edhe arsyetimin e Gjykatës së Apelit – në rastin në fjalë, e ka ftuar subjektin të paraqesë shpjegime lidhur me qartësimin e ecurisë dhe rrjedhën arsyetuese/vlerësuese të disa rrethanave apo elementeve specifike të pretenduara nga palët dhe mbi përshtatjen e zgjidhjes/vendimmarrjes së subjektit në çështjen në fjalë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

165. Subjekti ka parashtruar se në padinë nr. “*****” akti, datë 5.6.2015, të regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, pala paditëse A.H., ka parashtruar dy kërtime: kërkitimi i parë – pavlefshmëria e kontratës së *overdraft*-it për shkak të normës së interesit të përcaktuar në të dhe për faktin se nuk kishte dijeni që kishte detyrime ndaj palës së paditur; kërkitimi i dytë – zgjidhja e pasojave juridike të kësaj kontrate.

166. Bazuar në paragrafin e dytë të nenit 16 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët, por në asnjë rast gjykata nuk mund të ndryshojë bazën juridike të padisë pa kërkesën e palës.
167. Në vendimin e saj Gjykata e Apelit Tiranë referon vetëm në paragrafin e parë të nenit 16, ndërkohë që kjo dispozitë në paragrafin e dytë përcakton në mënyrë eksplicite dhe pa asnjë ekuivok kufijtë e gjykatës civile gjatë shqyrtimit të një çështjeje, në drejtim të pamundësisë së ndryshimit të bazës juridike të padisë pa një kërkesë të palës paditëse. Në rastin konkret, në asnjë moment të gjykimit pala paditëse nuk ka paraqitur kërkesa referuar nenit 16, paragrafi i dytë dhe nenit 185 të Kodit të Procedurës Civile, për ndryshimin apo shtimin e saj.
168. Gjithashtu, në vendimin e saj Gjykata e Apelit i referohet nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se: “(...) Janë tituj ekzekutivë: (...) d) (...) aktet për dhënien e kredive bankare ose aktet për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare (...)”. Në kuptim të kësaj norme procedurale janë tituj ekzekutivë, ndër të tjera, edhe aktet për dhënien e kredive bankare. Në vijim, sipas nenit 511 të Kodit të Procedurës Civile, titujt ekzekutivë vihen në ekzekutim pasi më parë lëshohet urdhri i ekzekutimit nga gjykata. Pra, në gjykimin për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit gjykata verifikon nëse kontrata e kredisë bankare plotëson të gjitha elementet ligjore të vlefshme për t’u konsideruar titull ekzekutiv. Mjetet e mbrojtjes kundër ekzekutimit të detyrimeve janë të përcaktuara në nenet 609 e vijues të Kodit të Procedurës Civile dhe përfshijnë: padinë për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv sipas nenit 609; ankimin për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore sipas nenit 610; dhe padinë për kërkimin e sendit nga personi i tretë, neni 612.
169. Pala paditëse A.H., nuk ka paraqitur një padi referuar nenit 609 të Kodit të Procedurës Civile, si e vetmja dispozitë përmes së cilës të mund të mbrohej në kuadër të nenit 510 të po këtij Kodi. Sikundër në asnjë moment të gjykimit, pala paditëse nuk ka paraqitur kërkesa referuar nenit 16, paragrafi i dytë dhe nenit 185 të Kodit të Procedurës Civile për ndryshimin apo shtimin e saj. Gjithashtu, pala paditëse A. H., nuk e ka kundërshtuar kontratën e *overdraft*-it si një titull ekzekutiv. Nuk ka rezultuar gjatë gjykimit që pala e paditur të ketë nisur procedurat për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit për kontratën e *overdraft*-it, datë 13.11.2008.
170. Pas rigjykimit të çështjes nga një trup tjetër gjykues, me vendimin nr. “****”, datë 8.10.2018, është vendosur “Rrëzimi i kërkesëpadisë së paditësit A.H., si e pambështetur në ligj dhe në prova (...)”. Pra, një gjyqtar tjetër ka konkluduar në të njëjtën mënyrë sa i takon të drejtës së pretenduar nga pala paditëse A.H.

Vlerësimi i trupit gjykues

171. Trupi gjykues, duke vlerësuar përmbajtjen e denoncimit në fjalë në raport me sa ka rezultuar nga aktet dhe dokumentet e administruara, si dhe duke mbajtur në vëmendje shpjegimet e paraqitura nga subjekti, në vlerësimin e kësaj çështjeje çmon t’i referohet qëndrimit unifikues në vendimin nr. 3, datë 29.3.2012, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku citohet: “(...) 32.1. Pamundësia e gjykatës për të ndryshuar bazën juridike të padisë konform nenit 16 (2) të Kodit të Procedurës Civile,

duhet vlerësuar si kufizim ligjor që përputhet me parashikimet e neneve 6, 10, 14, 20 (2), 28, 31 dhe 185 e që ka të bëjë me ndalimin që gjykata të shprehet për diçka që nuk i është kërkuar. Në këtë rast, gjykata mban parasysht se që të pranohet padia (qoftë edhe pjesërisht) duhet që të ketë lidhje midis objektit dhe shkakut të saj e nëse një gjë e tillë nuk ndodh atëherë padia rrëzohet. Gjykata ka të drejtë të vlerësojë në mënyrë të pavarur elementet e shkakut të padisë (faktin dhe të drejtën), por këtë e bën në kuadër të verifikimit të përputhshmërisë së kërimit të paditësit me ligjin. Kjo pasi është paditësi ai që merr iniciativën për fillimin e procesit gjyqësor civil dhe gjykata ka detyrimin të gjykojë çështjen me pavarësi dhe paanësi, duke u shprehur vetëm për atë objekt mosmarrëveshjeje dhe për atë shkak ligjor që paditësi parashtron para saj (...).”

172. Gjithashtu, trupi gjykues arsyeton se fakti që një gjykatë më e lartë, në këtë rast Gjykata e Apelit Tiranë, ka mbajtur një qëndrim të ndryshëm në vlerësimin e një çështjeje gjyqësore nga ajo që ka mbajtur subjekti i rivlerësimit, kjo nuk nënkupton se bëhet fjalë për shkelje konkrete procedurale apo dobësi në arsyetimin e vendimit nga subjekti, lidhur me të cilat Komisioni mund të shprehej duke i kualifikuar si mangësi në aftësitë e saj profesionale, nëse do të ishte rasti.
173. Ky arsyetim i trupit gjykues, përpos sa më sipër, gjen mbështetje edhe në metodologjinë e vlerësimit periodik të magjistratëve, të parashikuar nga ligji nr. 96/2016, referuar së cilës vërehet se nuk parashikohet si instrument matës i aftësive për gjykim apo arsyetim ligjor qëndrimi që gjykatat më të larta mbajnë mbi vendimet përkatëse të subjekteve nën vlerësim profesional, për sa kohë nuk konstatohen shkelje procedurale apo mangësi profesionale të tyre në ushtrimin e funksionit.

LIDHUR ME INFORMACIONE TË BËRA PUBLIKE NGA MEDIA

174. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është vënë në dijeni nga mjetet e informimit publik lidhur me një artikull të publikuar në media *online*, nga analizimi i të cilit është konstatuar sa vijon:

Në lidhje me artikullin e publikuar në portalin *cna.al*⁵⁰ dhe *tpz.al*⁵¹

175. Në median *online cna.al* ka rezultuar i publikuar artikulli me përmbajtjen si vijon: “Engjëllushe Tahiri, në vitin 2014, KLD, ka marrë masë disiplinore, vërejtje me paralajmërim, pas një inspektimi që ishte ndërmarrë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, në bazë të ankesave të qytetarëve. KLD-ja kishte konkluduar se subjekti i rivlerësimit duhet t’i nënshtruhej përgjegjësisë disiplinore, sipas neneve 31 dhe 32 të ligjit nr. 9877/2008, për kryerjen e akteve dhe sjelljeve që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit, si rrjedhojë e shkeljes së rëndë disiplinore të moszbatimit të një vendimi unifikues të Gjykatës së Lartë dhe shkeljeve të tjera të ligjit procedural civil, të konstatuara në veprimtarinë e saj gjyqësore... E njëjta gjyqtare, në vitin 2012 ka liruar nga burgu shtetasin R.R., duke pezulluar masën e arrestit me burg dhe duke e lënë Rr., e lirë me shërbim prove, përkundër kërkesës së Prokurorisë, e cila kërkoi një vit burg për djalin e deputetit, i cili akuzohej për dhunimin e shtetasës Xh. M., – edhe pse ai i kishte mohuar akuzat. Rr., u dënua 12 muaj shërbim prove, për akuzën e përndjekjes të Xh.M.’.

⁵⁰ <https://www.cna.al/2021/02/21/lirroi-djalin-e-deputetit-socialist-klgj-shperblen-gjyqtaren>

⁵¹ <https://www.tpz.al/dhunoi-xhisielen-gjykata-e-krujes-liron-rexhep-rrajen-djalin-e-deputetit-te-ps-se>

176. Komisioni, përgjatë procesit të rivlerësimit, ka konstatuar se në lidhje me masën disiplinore të dhënë ndaj subjektit të rivlerësimit nga ish-KLD-ja, KLGJ-ja, në raportin e përcjellë pranë Komisionit, ka analizuar dhe trajtuar historikun dhe detajet e kësaj çështjeje. Konkretisht, vendimi nr. “*****”, datë 15.4.2014, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, për dhënien e masës disiplinore ndaj gjyqtares, është ankimuar nga subjekti i rivlerësimit dhe Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. “*****”, datë 7.7.2014, ka vendosur rrëzimin e ankimit. Më pas, subjekti i rivlerësimit Engjëllushe Tahiri i është drejtuar Gjykatës së Lartë, e cila me vendimin nr. “*****”, datë 5.5.2015, ka vendosur “Ndryshimin e vendimit nr. “*****”, datë 7.7.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit dhe pranimin e padisë. Shfuqizimin e vendimit nr. “*****”, datë 15.4.2014, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.
177. Në lidhje me publikimin e sipërpërkthuar, i cili referon një çështje gjyqësore me palë shtetasit R. Rr. dhe Xh. M., Komisioni ka administruar dokumentacionin përkatës nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë. Nga shqyrtimi i vendimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit ka rezultuar se prokurori kishte kërkuar dënimin e të pandehurit R. Rr., me 1 vit burgim, i akuzuar për veprën penale “përndjekje”, parashikuar nga neni 121/a/2 i Kodit Penal. Mbrojtësi i tij kishte kërkuar deklarin e pafajshëm të tij, si dhe në rast se subjekti i rivlerësimit do ta shpallte atë të fajshëm të aplikohet ndaj tij neni 59 i Kodit Penal. Gjatë gjykimit, kallëzuesja ka deklaruar se nuk ndihej e kërcënuar apo e pasigurt për jetën e saj dhe se kallëzimin e kishte bërë për shkak të xhelozisë. Nga aktet ka rezultuar se ndaj të pandehurit, prokuroria, në datën 29.9.2019, kishte kërkuar caktimin e masës së sigurisë në mungesë, “arrest në burg”. Masa e sigurisë ishte pranuar nga gjykata dhe në datën 30.9.2019 ishte bërë arrestimi i të pandehurit.
178. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. “*****”, datë 20.12.2018, ka vendosur deklarin fajtor të shtetasit R.Rr., për kryerjen e veprës penale “përndjekje”, parashikuar nga neni 121/a/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 18 muaj burgim. Bazuar në nenin 406 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur uljen e dënimit me 1/3 dhe dënimin përfundimisht me 12 muaj burgim. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pezullimin e dënimit me burgim dhe vënien e tij në periudhë prove prej 6 muajsh. Në caktimin e masës së dënimit, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur në konsideratë faktin që i pandehuri nuk ka qenë i dënuar më parë, faktin që nëna e tij ka qenë e sëmurë, faktin që marrëdhëniet mes tij dhe viktimës tashmë ishin normalizuar, si dhe faktin që ai kishte kryer deri në datën e dhënies së vendimit 4 muaj burg. Gjatë procesit të rivlerësimit, Gjykata e Apelit Tiranë ka bërë me dije se çështja në fjalë është në proces përpunimi në këtë gjykatë.
179. Në përfundim, lidhur me sa është trajtuar më sipër, konkludohet se nuk kanë rezultuar shkelje procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit. Vlerësimi në lidhje me caktimin e masës dhe llojit të dënimit është në tagrin e gjyqtarit të çështjes dhe në rastin konkret është bërë në përputhje me kriteret e përcaktuara ligjore, si dhe brenda marzheve të dënimit të përcaktuar nga neni 121/a i Kodit Penal.

Konkluzion lidhur me kriterin e aftësive profesionale

180. Në analizë të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, denoncimeve të depozituara nga publiku, shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe

dokumentacionit të administruar, Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje procedurale, gabime thelbësore dhe/ose serioze në lidhje me shqyrtimet apo vendimmarrjet e tij – shkaqe këto që mund të çonin në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se bazuar në sa më lart, subjekti i rivlerësimit Engjëllushe Tahiri ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, shkronja “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Engjëllushe Tahiri:

- a) ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b) ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c) ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe të pikave 1 dhe 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Engjëllushe Tahiri, gjyqtare në Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm Krujë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në datën 19.6.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Brunilda BEKTESHI
Kryesuese

Lulzim HAMITAJ
Relator

Etleda ÇIFTJA
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Gledis Hajdini